

Behxhet Mustafa, Avni Hajdari, Shpresa Sojeva-Mustafa

BIOLOGJIA

Për klasën e nëntë të arsimit të mesëm të ulët



Libri i mësimdhënësit/es

dukagjini
shtëpia botuese publishing house

Prishtinë, 2022

PËRMBAJTJA

Parathënie 5

Plani vjetor 6

Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve (plani vjetor) 7

Plani dymujor: shtator – tetor 8

Pjesa e parë

Proceset jetësore - metabolizmi

Fotosinteza

Fazat e fotosintezës

Frymëmarrja qelizore dhe prodhimi i energjisë

Tipat e frymëmarrjes te shtazët

Qarkullimi i ujit në bimë dhe tajitja

Tipat e tajitjes te shtazët dhe te njeriu

Ndërtimi dhe roli i lëndëve organike

Plani dymujor: nëntor – dhjetor 13

Pjesa e dytë

Cikli jetësor i organizmave

Cikli qelizor

Proceset e ciklit jetësor të bimëve dhe të shtazëve

Cikli jetësor i bimëve me spore

Cikli jetësor i bimëve me farë

Cikli i jetësor i shtazëve

Cikli i zhvillimit të shpendëve (zogjve)

Pllenimi artificial

Plani tremujor: janar - shkurt – mars 17

Pjesa e tretë

Trashëgimia te njeriu

Trashëgimia dhe mjedisi

Ligjet e Gregor Mendelit - bazat e trashëgimisë

Vetitë e individët pasardhës caktohen nga dy gjene alele

Vetitë që i përcaktojnë kromozomet autosome dhe kromozomet seksuale

Pjesa e katërt

Zhvillimi individual i njeriut

Formimi i qelizave seksuale - spermatogjeneza dhe oogjeneza

Shtatzënia dhe lindja e fëmijës

Plani tremujor: prill – maj – qershor..... 22

Pjesa e pestë

Evolucioni - ndryshues i formave jetësore

Llojet ndryshojnë

Dëshmitë e tjera mbi evolucionin

Seleksionimi natyror

Cila është origjina e jetës?

Si ka shkuar zhvillimi i kurrizorëve

Evolucioni i njeriut

Pjesa e gjashtë

Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Trupi i njeriut dhe shëndeti

Diversiteti në seksualitet te njerëzit

Sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe roli i higjienës personale për evitimin e tyre

Sëmundjet trashëguese te njerëzit

Planifikimi i orës mësimore31-123

Testi 1124

PARATHËNIE

Libri i mësimdhënësit/es "Biologjia 9" është hartuar në bazë të planprogramit mësimor, sipas Kurrikulës së re të aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të Kosovës. Libri është përgatitur për fushën kurrikulare: Shkencat e natyrës, lëndën: Biologji 9, Shkallën e kurrikulës: IV.

Ky libër është pjesë e kompletit të librit të mëimit "Biologjia 9" dhe do t'u shërbejë mësimdhënësve/eve si mjet ndihmës për ta zbërthyer përmbajtjen e lëndës, e cila është organizuar sipas koncepteve, temave, njësive mësimore dhe rezultateve të të nxënit të lëndës (RNL).

Në këtë libër keni modelet për planin vjetor, planet dymujore, ato tremujore, si dhe është dhënë një model i orës së mëimit për secilën njësi mësimore (zhvillim), i cili mund të përdoret për realizimin e orës mësimore. Për çdo njësi mësimore janë të prezentuara rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL), kriteret e suksesit, fjalët kyçe, burimet, lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare, metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve.

Në librin e mësimdhënësit/es jepen shembuj të ndryshëm të metodologjive, që mund të përdoren për ta bërë përmbajtjen të arritshme për nxënësit. Në libër gjeni dhe një test si shembull që ju ndihmon për vlerësimin e nxënësve.

Mirëpo, kjo nuk do të thotë që mësimdhënësit/et nuk mund të përzgjedhin metoda dhe planifikime të tjera për realizimin e njësive mësimore. Ata mund t'i përshtatin metodologjitë, strategjitë dhe teknikat e mësimdhënies, varësisht nga nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me qëllim të arritjes së rezultateve të pritura të të nxënit për orë mësimore. Ky model i librit të mësimdhënësit/es është bërë duke u konsultuar edhe me mësimdhënësit të biologjisë të shkollës së mesme të ulët dhe të lartë.

Koha mësimore (orë mësimore) për një njësi mbetet në kompetencat e mësimdhënësit/es.

Ju urojmë suksese në mësimdhënie dhe arritje në rezultate të të nxënit!

Autorët.

PLANI VJETOR

TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE (PLANI VJETOR)

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: Shkalla IV	Klasa: 9
---	---------------------------	---	---------------------------

Koncepti: Bota e gjallë			
PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)	PERIUDHA (III)
Shtator - tetor	Nëntor - dhjetor	Janar - shkurt - mars	Prill – maj – qershor
Metabolizmi	Cikli jetësor i organizmave	Trashëgimia te njeriu Zhvillimi individual i njeriut	Evolucioni Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut
Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës IV, klasa IX			
I-Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv			
1,2,5,6,8;			
II-Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ			
1,2,6,7,8;			
III-Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm			
2,5, 7;			
IV-Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv			
1			
V-Kompetenca personale – Individ i shëndoshë			
7, 8,9			
VI-Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm			
1,6,			

Plani dymujor

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e Periudha I Shkalla IV	Klasa: 9
---	---------------------------	---	--------------------

PLANI DYMUJOR: SHTATOR – TETOR

Tema- mësimore : Proceset jetësore - metabolizmi

RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen

- I- 1.** Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.
- 5.** Prezenton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshetuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.
- 6.** Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshatshëm dhe të saktë, dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.
- III 1.**Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për ta sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.
- 2.** Përzgjedh informata nga burime të ndryshme për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar, dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.
- 7.** Interpretton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.
- 8.** Identifikon, me anë të krahasimit, dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak - pasojë midis këtyre dukurive.
- III. 7.** Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënimit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

IV. 1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.

VI- 1. Praktikoni të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë në situata konkrete jetësore të përditshme, qoftë në klasë, qoftë në shkollë apo gjëtiu (si: gjatë diskutimit, respektimit të mendimit të tjetrit etj.).

RNF- Rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke i referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

Temat/ mësimore	Rezultatet e të nxënimit për temë mësimore RNL	Njësitë: Mësimore	Koha mësimore (orë)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, më gëshjet	Burimet
-----------------	--	-------------------	---------------------	-----------------------------	---------------------------	---	---------

<p>Metaboli - zmi</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon konceptet: metabolizëm, anabolizëm dhe katabolizëm. • Analizon përkufizimet, rolin, ndërlidhjen e proceseve metabolike (frymëmarrjen, fotosintezën, tajtjen, fermentimin etj.). • Përshkruan fotosintezën si proces metabolik - faza e dritës, faza e errësirës. 	<p>2</p>	<p>Proceset jetësore- Metabolizmi</p>	<p>Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj);</p> <p>Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);</p> <p>Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;</p>	<p>Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezentime);</p> <p>Vlerësimi me shkrim, i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raporteve të punës);</p> <p>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale;</p> <p>Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte; Vlerësimi i portfolit; Vlerësimi individual dhe grupor</p> <p>gjatë punës kërkimore; • Vlerësimi i detyrave të shtëpisë;</p>	<p>Gjuhë dhe komunikim</p> <p>Fizikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Edukatë qytetare</p> <p>Gjeografi</p> <p>TIK</p> <p>Histori</p> <p>Art figurativ</p>	<p>Biologjia</p> <p>9</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Analizon përkufizimet, rolin, ndërlidhjen e proceseve metabolike (frymëmarrjen, fotosintezën, tajtjen, fermentimin etj.). • Përshkruan fotosintezën si proces metabolik - faza e dritës, faza e errësirës. 	<p>2</p>	<p>Frymëmarrja qelizore dhe prodhimi i energjisë</p>	<p>Të mësuarit përmes projekteve;</p>	<p>Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezentime);</p>	<p>Gjuhë dhe komunikim</p>	<p>Biologjia</p>	
<p>frymëmarrjes te bimët ujore dhe tokësore.</p> <p>• Shiuan</p>	<p>10 BIOLOGJIA 9</p>	<p>- LIBRI I MËSIMDHËNËSIT/ES</p>					

<ul style="list-style-type: none"> • Emërton dhe krahason tipat e frymëmarrjes (frymëmarrje e brendshme dhe e jashtme), si dhe llojet e frymëmarrjes (trakeidale, branshiale, lëkurore, mushkërore etj.) te grupet e ndryshme të shtazëve. 	<p>Tipat e frymëmarrjes te shtazët</p>	<p>1</p>	<p>Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezentime);</p> <p>Vlerësimi me shkrim, i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raporteve të punës);</p> <p>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale;</p> <p>Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte; Vlerësimi i portfolit; Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore; • Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.</p>		
<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan proceset metabolike, transpiracionin dhe gutacionin, si dhe rolin dhe rëndësinë e ujit në turgorin e qelizës. 	<p>Transpirimi</p>	<p>1</p>			
<ul style="list-style-type: none"> Shpjegon tajtjen bimore, llojet dhe rëndësinë 	<p>Gutacioni</p>	<p>1</p>			
<ul style="list-style-type: none"> • Hulumton 	<p>e tajtjes te bimët.</p>	<p>11 BIOLOGJIA 9</p>	<p>- LIBRI I MËSIMDHËNËSIT/ES</p>		

	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton, vlerëson dhe analizon ndërtimin, rolin dhe rëndësinë e produkteve metabolike (proteinave, sheqernave, yndyrave, vitaminave, enzimeve etj), si dhe rrugët e metabolizmit të tyre. 	<p>Ndërtimi dhe roli i lëndëve organike</p> <p>2</p>				
	<p>Test i shkurtër</p>	<p>1</p>				

Periudha I

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: Shkalla IV	Klasa: 9
---	---------------------------	--	--------------------

PLANI DYMUJOR: NËNTOR – DHJETOR

Tema-t mësimore : Cikli jetësor i organizmave

RNK- Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen

- I- 1.** Transmeton saktë të dhënat e dhënat e mbledhura për një temë konkrete në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.
- 5.** Prezenton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshtuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.
- 6.** Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikon adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë, dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.
- 8.** Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën, duke u përgjigjur dhe duke veçuar informatat kryesore.
- II 1.** Paraqet në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për ta sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.
- 7.** Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.
- 8.** Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak - pasojë midis këtyre dukurive.
- III. 2.** Shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burimet e tjera gjatë ndërtimit të një ideje ose të një projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj.
- 7.** Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënimit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton

nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

IV. 1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur në forma të ndryshme të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkatarrët e sëmundjeve të njeriut, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me gëshjet ndërkurrikulare	Burimet

<p>Cikli jetësor i organizmave</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan procesin e formimit të qelizave seksuale. • Analizon ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet mitozës dhe mejozës. • Shpjegon ndryshimin e ADN-së dhe të kromozomeve gjatë ndarjes qelizore. • Shpjegon konceptet dhe përkufizimet kryesore në procesin e një cikli jetësor. • Analizon shembuj të ciklit jetësor te bota bimore. • Shpjegon ciklin e zhvillimit të bimëve me spore. • Shpjegon ciklin e zhvillimit të bimëve me farë. Shpjegon procesin e rritjes dhe zhvillimin e bimëve me farë, dhe faktorët që ndikojnë në rritjen dhe në zhvillimin e bimëve. • Analizon shembuj të ciklit jetësor te bota shtazore. • Vlerëson rolin e shumimit në zhvillimin e botës së gjallë. • Hulumton dhe vlerëson fazat kryesore të zhvillimit embrional tek ujëtokësorët (në shembullin e bretkosës) dhe të shpendët (në shembullin e zogut të pulës). Krahason fazat e zhvillimit të drejtpërdrejtë dhe me metamorfozë të dy përfaqësues të kurrizorëve. 	<p>Mitoza</p> <p>Mejoza</p> <p>Cikli jetësor i bimëve me spore</p> <p>Cikli jetësor i bimëve me farë</p> <p>Cikli jetësor i shtazëve</p>	<p>2</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>2</p> <p>2</p>	<p>Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj):</p> <p>Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);</p> <p>Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;</p> <p>Të mësuarit përmes projekteve;</p>	<p>Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezentime);</p> <p>Vlerësimi me shkrim, i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raporteve të punës);</p> <p>Vlerësimi i punës praktike/eksperi-mentale;</p> <p>Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte;</p> <p>Vlerësimi i portfolit; Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore; • Vlerësimi i detyrave të shtëpisë;</p> <p>Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezentime);</p> <p>Vlerësimi me shkrim, i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raporteve të punës);</p> <p>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale • Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte • Vlerësimi i portfolios • Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore • Vlerësimi i detyrave të shtëpisë</p>	<p>Gjuhë dhe komunikim</p> <p>Fizikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Edukatë qytetare</p> <p>Gjeografi</p> <p>TIK</p> <p>Histori</p> <p>Art figurativ</p>	<p>Biologjia</p> <p>9</p>
---	--	---	---	--	--	--	---

	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerëson rolin e shumimit në zhvillimin e botës së gjallë. • Hulumton dhe vlerëson fazat kryesore të zhvillimit embrional tek ujëtokësorët (në shembullin e bretkosës) dhe te shpendët (në shembullin e zogut të pulës). • Hulumton disa grupe kurrizorësh, ku zhvillimi embrional kryhet në ambientin e jashtëm, kurse te të tjerët në brendi të trupit. • Shpjegon konceptin e frytnimit artificial. • Hulumton disa grupe kurrizorësh, ku zhvillimi embrional kryhet në ambientin e jashtëm, kurse te të tjerët në brendi të trupit. • Hulumton dhe përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet gjatë procesit të zhvillimit embrional tek organizmat e ndryshëm. 	<p>Cikli i zhvillimit të shpendëve</p> <p>Pllenimi artificial</p> <p>Pllenimi artificial te njeriu</p> <p>Vlerësim</p>	<p>2</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>2</p>			
--	--	--	---	--	--	--

Periudha II

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: Shkalla IV	Klasa: 9
--	---------------------------	---	---------------------------

PLANI TREMUJOR: JANAR - SHKURT - MARS

Tema-t mësimore : Trashëgimia te njeriu - zhvillimi individual i njeriut

RNK- Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen

I- 1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

2. Përshkruan një ngjarje, të dhënë si detyrë, të lexuar ose të dëgjuar më parë, në formë verbale, vizuale ose me shkrim, duke ruajtur rjedhën logjike të saj.

5. Prezenton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshtuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.

6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

8. Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën, duke u përgjigjur dhe duke veçuar informatën kryesore.

III 1. Paraqet në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për ta forcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.

2. Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.

7. Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.

8. Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri,

duke vënë në dukje lidhjen shkak - pasojë midis këtyre dukurive.

III. 2. Shfrytëzon në mënyrë efektive fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burimet e tjera gjatë ndërtimit të një ideje ose projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj.

5. Paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti, duke e sqaruar dhe duke e argumentuar më pas këtë para të tjerëve.

7. Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

IV. 1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur në forma të ndryshme të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkollës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin dhe qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke i referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

Tema/t mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me gëshfjet ndërkurrikulare	Burimet

Trashëgimia te njeriu	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon konceptet dhe përkufizimet themelore të trashëgimisë te bota e gjallë, me theks trashëgiminë te njeriu. • Përshkruan ndërtimin e bërthamës qelizore. Shpjegon materialin bërthamor, me theks ndërtimin e kromozomeve. • Emërton katër bazat azotike të ADN-së. • Shpjegon ADN-në dhe dyfishimin (replikimin) e ADN-së. • Vlerëson rolin e kromozomeve në trashëgimi. Vlerëson rolin e trashëgimisë te njeriu. 	Trashëgimia dhe njedisi AND – ja, molekulë e jetës	2	Mësimdhënie drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj); Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;	Vlerësimi me gojë (diskutime, debata, prezentime); Vlerësimi me shkrim, i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raporteve të punës); • Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale; • Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte; • Vlerësimi i portfolit; • Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore; • Vlerësimi i detyrave të shtëpisë	Gjuhë dhe komunikim Fizikë Matematikë Edukatë qytetare Gjeografi TIK Histori Art figurativ	Biologjia 9
Zhvillimi individual i njeriut	<ul style="list-style-type: none"> • Arsyeton dallimin në numrin e kromozomeve në qelizat trupore dhe në qelizat seksuale (gamete). Shpjegon shumimin e qelizave te njeriu (krahason mitozën dhe mejozën). 	Mjedisi ka ndikim në paraqitjen e vetive	2	Të mësuarit përmes projekteve;			

	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon kryqëzimin dhe rregullat e trashëgimisë bazuar në Ligjet e Mendelit. • Zbaton parimet e trashëgimisë së Menedelit për të bërë parashikime lidhur me paraqitjen e cilësive në pasardhës. • Zbaton parimet e trashëgimisë së Menedelit për të bërë parashikime lidhur me paraqitjen e seksit/gjinisë së pasardhësit të njeriut. Shpjegon trashëgiminë e veçorive dominante dhe recesive të njeriut. • Zbaton parimet e trashëgimisë së Menedelit për të bërë parashikime lidhur me paraqitjen e seksit/gjinisë së pasardhësit të njeriut. • Vlerëson rolin e trashëgimisë të njeriut. Hulumton me cilin kombinim të kromozomeve seksuale përcaktohet seksi mashkullor dhe ai femëror të njeriut. 	<p>Gregor Mendeli, një studios i madh i trashëgimisë;</p> <p>Ligjet e Gregor Mendelit - bazat e trashëgimisë;</p>	<p>2</p> <p>2</p> <p>2</p>			
--	---	---	----------------------------	--	--	--

<p>Zhvillimi individual i njeriut</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Numëron disa cilësi që i përcaktojnë kromozomet autosome dhe kromozomet seksuale. • Definin termin mutacion dhe emërton disa faktorë mutagjenë. • Vlerëson rolin e trashëgimisë të njeriut. • Përshkruan krijimin e qelizave seksuale të njeriut (spermatogjeneza dhe oogjeneza). • Shpjegon si kryhet frytërimi dhe formimi i zigotës. Përshkruan si zhvillohet shtatzënia (graviditeti). • Përshkruan zhvillimin embrional të njeriut (nga zigota deri të lindja). • Përshkruan zhvillimin pasembrional të njeriut (të ndarë në faza). • Numëron dhe përshkruan etapat e zhvillimit embrional dhe pasembrional të njeriut (përmes paraqitjes figurative të ciklit jetësor të njeriut). 	<p>Vetitë që i përcaktojnë kromozomet autosome dhe kromozomet seksuale;</p> <p>Vlerësim i shkurtër;</p> <p>Formimi i qelizave seksuale - spermatogjeneza dhe oogjeneza;</p> <p>Shtatzënia dhe lindja e fëmijës;</p> <p>Vlerësim</p>	<p>2</p> <p>1</p> <p>2</p> <p>2</p> <p>2</p>			
--	---	---	--	--	--	--

Periudha III

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: Shkalla IV	Klasa: 9
---	---------------------------	--	--------------------

PLANI TREMUJOR: PRILL – MAJ - QERSHOR

Tema/t mësimore : Evolucioni, shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen

I- 1. Transmeton saktë të dhënat e dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

2. Përkshkruan një ngjarje, të dhënë si detyrë, të lexuar ose të dëgjuar më parë, në formë verbale, vizuale ose me shkrim, duke ruajtur rrjedhën logjike të saj.

5. Prezenton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshtuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.

6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë, dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

8. Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën, duke u përgjigjur dhe duke veçuar informatën kryesore.

II 1. Paraqet në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për ta sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.

6. Demonstron zgjidhjen e një problemi (matematik, lingvistik etj.), bazuar në të dhënat tekstuale ose tekstuale numerike, eksperimentale të detyrës, e cila bëhet në klasë/shkollë apo jashtë saj, duke arsyetuar me gojë zbatimin e ecurive përkatëse për arritjen e rezulttit.

- 7.** Interpretton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.
- 8.** Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak - pasojë midis këtyre dukurive.
- III. 2.** Shfrytëzon në mënyrë efektive fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burimet e tjera gjatë ndërtimit të një ideje ose projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj.
- 5.** Paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti, duke e sqaruar dhe duke e argumentuar më pas këtë para të tjerëve.
- 7.** Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.
- IV. 1.** Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.
- V. 7.** U shpjegon moshatarëve, me forma dhe mjete të ndryshme të komunikimit, rëndësinë e identifikimit të personave dhe shërbimeve kompetente, veç e veç, të nevojshme për mbështetje në situata që konsiderohen potencialisht të rrezikshme për shëndetin fizik dhe mendor.
- 8.** Përkshkruan mundësitë, rreziqet dhe pasojat e infeksioneve dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe sqaron mënyrat dhe mjetet për parandalimin e tyre, duke përdorur forma të ndryshme të prezentimit (të folur, të shkruar, grafik, me pllakate, me pamflete, me lojë teatrale, me performancë artistike etj).
- 9.** Reagon ndaj sjelljeve asociiale të moshatarëve, duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehitë negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo i drogës).
- VI 1.** Praktikon të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë në situata konkrete jetësore të përditshme, qoftë në klasë, qoftë në shkollë apo gjetiu (si: gjatë diskutimit, respektimit të mendimit të tjetrit etj).
- 6.** Identifikon paragjykimet apo dukuritë jo të mira në klasë, në shkollë apo në komunitet, merr qëndrim ndaj tyre, duke propozuar veprime konkrete për luftimin e tyre.

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shpjegimit të temës/ve:

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

Evolucio-ni	Shpjegon teoritë e zhvillimit (evolucionit) të botës së gjallë. • Analizon faktorët e ndryshëm evolutivë që ndikuan në zhvillimin dhe përsosjen e qenieve të gjalla.	Evolucioni- ndryshues i formave jetësore	2	Mësimdhënie drejtpërdrejtë (shpjegim, ushtrime praktike dhe shembuj);	Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezentime);	Gjuhë dhe komunikim	Biologjia 9
	Shpjegon teoritë e zhvillimit (evolucionit) të botës së gjallë. • Analizon faktorët e ndryshëm evolutivë që ndikuan në zhvillimin dhe përsosjen e qenieve të gjalla.	Llojet ndryshojnë	1	Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);	Vlerësimi me shkrim, i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raporteve të punës);	Fizikë	
	Shpjegon teoritë e zhvillimit (evolucionit) të botës së gjallë. • Analizon faktorët e ndryshëm evolutivë që ndikuan në zhvillimin dhe përsosjen e qenieve të gjalla. Zbaton dhe komenton fjalorin dhe përkufizimet kryesore që kanë të bëjnë me evolucionin.	Dëshmitë e tjera mbi evolucionin dhe seleksionimi natyror	2	Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;	Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale; • Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte;	Matematikë	
	• Shpjegon teoritë e zhvillimit (evolucionit) të botës së gjallë. • Shpjegon origjinën e njeriut si produkt të përzgjedhjes natyrore dhe të kushteve jetësore.	Cila është origjina e jetës dhe si ka shkuar zhvillimi i kurrizorëve?	2	Të mësuarit përmes projekteve	• Vlerësimi i portfolit;	Edukatë qytetare	
	• Përshkruan origjinën e njeriut dhe numëron paraardhësit e tij.	Evolucioni i njeriut	2		• Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore;	Histori	
	• Shpjegon origjinën e njeriut si produkt të përzgjedhjes natyrore dhe të kushteve jetësore.				• Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.	Art figurativ	
	• Përshkruan origjinën e njeriut dhe numëron paraardhësit e tij. • Analizon racat njerëzore dhe kushtet që kanë ndikuar në lindjen e racave njerëzore.						
	• Emërton racat kryesore dhe interpreton pikëpamjet pseudoshkencore për racat.						
	• Shpjegon irregullimin e jetës shoqërore të njeriut (normat shoqërore, morale dhe ligjet juridike).						

<p>Shëndeti, sjelljet dhe emocionete njeriut</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon konceptet dhe përkufizimet themelore të trupit të njeriu. • Analizon faktorët, të cilët ndikojnë në shëndetin fizik dhe emocional të njeriut. • Vlerëson rolin e shëndetit për njeriun. • Respekton diversitetin në seksualitet dhe orientimin seksual. • Argumenton përparësitë dhe rreziqet gjatë marrjes së vendimit rreth marrëdhënieve seksuale. • Diskuton për shtatzëninë, duke analizuar prindërimin në moshë të re (adoleshencë). • Analizon të drejtat riprodhuese dhe identifikon shtigmen, diskriminimin, abuzimin etj., në situata të ndryshme. • Shpjegon shkaqet e paraqitjes së sëmundjeve seksuale dhe vlerëson rolin e higjienës personale për evitimin e tyre. • Emërton disa sëmundje që lidhen me seksin dhe përshkruan si shfaqen ato. • Emërton dhe dallon sëmundjet trashëguese të njeriut. • Vlerëson rolin e shëndetit për njeriun. 	<p>Trupi i njeriut dhe shëndeti</p> <p>Diversiteti në seksualitet të njerëzit</p> <p>Sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe roli i higjienës personale për evitimin e tyre</p> <p>Sëmundjet trashëguese të njeriut</p> <p>Vlerësim</p>	<p>2</p> <p>2</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>2</p>		
---	--	--	---	--	--

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: IX	
Tema (nga plani dymujor): <i>Metabolizmi</i>	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <i>Shpjegon konceptet: metabolizëm, anabolizëm dhe katabolizëm.</i>
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I- 1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit. 6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë, dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. II- 8. Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak - pasojë midis këtyre dukurive.	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : <i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i>	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Proceset jetësore - metabolizmi	
Fjalët kyçe: metabolizëm, anabolizëm, katabolizëm, materie, reaksion, energji	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <i>Shpjegon termat anabolizëm, katabolizëm; Veçon faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e metabolizmit; Tregon në cilin nga proceset lirohet energjia, e për cilin shpenzohet energjia;</i>	
Kriteret e suksesit: <i>Jep të paktën një shembull të një procesi anabolik; Jep të paktën një shembull të një procesi katabolik;</i>	

Veço karakteristikat e metabolizmit të shpejtë dhe më të ngadaltë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, tabela, shkumësi, fletorja, lapsi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fizikë, Kimi, Gjuhë dhe komunikim.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

LINK (rendit, grupo, shëno)

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë konceptin “metabolizëm” dhe nxit nxënësit të shkruajnë sa më shumë toggjalësja në lidhje me të nga njohuritë që ata kanë. Mësimdhënësi/ja i lë nxënësit për 3-4 minuta në dyshe që t’i renditin në letër mendimet e tyre, pra t’i bashkojnë me mendimet e shokut/shoqes.

Disa nga mendimet e nxënësve mund të jenë këto, si psh:

“Metabolizmi nënkupton këmbimin e pandërprerë të materies midis organizmit të gjallë dhe ambientit të jashtëm”, apo “Metabolizmi ka të bëjë me dietat ushqimore, me tretjen e ushqimit” etj. Nxënësit përgjigjen lirshëm për ato që dinë për këtë koncept apo për këto procese. Mësimdhënësi/ja i rendit këto emërtime në tabelë dhe më pas kërkon shpjegime nga nxënësit për këto emërtime.

HARTA E KONCEPTIT

Mësimdhënësi/ja paraqet hartën e konceptit në formën e tabelës dhe kërkon nga nxënësit ta lexojnë tekstin dhe i vë nxënësit të punojnë në dyshe, duke plotësuar një tabelë si ajo e paraqitur në klasë.

Koncepti	Shpjegimi
Metabolizëm	Metabolizmi është term i përbashkët i proceseve (reaksioneve) kimike, të cilat janë bazë e rritjes, e ngacmueshmërisë, e lëvizjes, e ndarjes dhe e riprodhimit të qelizës.
Katabolizëm (jep shembuj)	
Anabolizëm (jep shembuj)	
Forma të transformimit të energjisë	
Energjia e rrezeve të dritës	
Energjia kimike e karbohidrateve dhe e molekulave të tjera	
Energjia biologjikisht e përdorshme	

(shembulli i tabelës së koncepteve)

DISKUTIM

**Në pjesën përfundimtare, mësime dhënësi/ja fton nxënësit që të marrin pjesë në diskutimin e hapur për gjithë klasën, kërkon nga nxënësit që, bazuar në atë që kanë lexur deri tani dhe sa kanë kuptuar, të japin shpjegimin përkatës (duke u përgjigjur në konceptet për të cilat kanë shkruar).*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndersjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Gjeni shembuj nga jeta e përditshme për proceset anabolike dhe katabolike.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: IX

Tema (nga plani dymujor):

Metabolizmi

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Analizon përkufizimet, rolin, ndërlidhjen e proceseve metabolike (frymëmarrjen, fotosintezën, tajitjen, fermentimin etj).

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I- 1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

5. Prezenton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshtuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.

6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikon adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë, dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Fotosinteza**

Fjalët kyçe: fotosintezë, prodhues, klorofil, kloroplast, gjethe

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Vlerëson rëndësinë e procesit të fotosintezës;

Përshkruan rolin e kloroplasteve;

Kriteret e suksesit:

Argumento me të paktën një shembull pse ka kaq shumë rëndësi fotosinteza për bimën dhe njeriun;

Veço ndërtimin e gjethes, e në veçanti të kloroplasteve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, tabela, shkumësi, fletorja, lapsi, llaptopi, fotografia.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fizikë, Kimi, Gjuhë dhe komunikim, TIK.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve ta shikojnë me vëmendje fotografinë dhe pastaj t'i japin përgjigjet e tyre në lidhje me atë se çfarë shohin.




UDHËZUES I TË LEXUARIT NDËRVEPRUES

Mësimdhënësi/ja paraqet para nxënësve një udhëzues që t'i ndihmojë nxënësit ta përqendrojnë vëmendjen gjatë leximit. Ndan klasën në grupe pune dhe kërkon prej tyre që të mendojnë në mënyrë kritike rreth materialit që do ta lexojnë, sepse edhe atë e ka ndarë në dy grupe, që pastaj të arrijnë në përfundime të sakta.

Pasi grupi i parë ka lexuar pjesën e tij (si e bëjnë bimët ushqimin e tyre), mësimdhënësi/ja fton ndonjërin nga ta që ta komentojë pjesën e lexuar me disa fjali. Ndërsa nxënësit e grupit të dytë kanë për detyrë të bëjnë sa më shumë pyetje për pjesën që do të shpjegohet nga grupi i parë. E njëjta vlen edhe për grupin e parë që do të bëjë pyetje për grupin e dytë, posa ata të mbarojnë me sqarimet e nevojshme për pjesën që e kanë lexuar (ndërtimi dhe funksioni i gjetheve).

KLLASTER

Pastaj, krejt në fund, të dyja grupet punojnë një kllaster të përbashkët në tabelë, e për ndërtimin e tij sigurisht ndihmojnë pyetjet e bëra më parë.



(një shembull i kllasterit)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë). Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani

dymujor): **Metabolizmi**

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Përshkruan fotosintezën si proces metabolik - faza e dritës, faza e errësirës.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

II- 2 Për zgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar, dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.

III- 7 Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Fazat e fotosintezës**

Fjalët kyçe: *faza biosintetike, cikli Kalvin, sheqer, energji*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Përshkruan fazat e fotosintezës;

Analizon rëndësinë e fotosintezës për gjallesat;

Kriteret e suksesit:

Defino fazën e errësirës dhe fazën e dritës;

Vlerëso procesin e fotosintezës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, shkumësi, tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata

jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë konceptin “ FOTOSINTEZË” dhe u kërkon nxënësve t’i shpalosin njohuritë e tyre lidhur me temën, duke u bazuar në njohuritë paraprake. Pasi kanë menduar në heshtje, u jep fjalën nxënësve të shprehin atë çfarë kanë menduar, mendimet e tyre mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë pa i mohuar apo pohuar ato.

DRTA

Në vijim, mësimdhënësi/ja ua shpjegon nxënësve procedurën, e cila do të zhvillohet si më poshtë: hapet teksti në temën mësimore “fazat e fotosintezës” dhe u kërkon nxënësve që të lexojnë me pjesë të ndara, pra sipas leximit të drejtuar DRTA, duke realizuar kështu realizimin e kuptimit. Pra, fillimisht nxënësit lexojnë pjesën e parë, pastaj ndalojnë se lexuari dhe fillojnë diskutimin se për çfarë ishte bërë fjalë në tekstin e lexuar. Më pas, vazhdohet me paragrafin e dytë: “Pse fotosinteza është e rëndësishme për gjallesat?”, lexohet teksti, nxënësit në fund mbyllin librat dhe përsëri e fillojnë diskutimin. Në po të njëjtën formë vazhdohet edhe me pjesën e fundit, nxënësit e lexojnë në heshtje dhe fillojnë diskutimin për pjesën “ Si e përdorin bimët ushqimin që e prodhojnë vetë?”.

Kllaster

Në pjesën e fundit të orës, nxënësit, për ta realizuar reflektimin, punojnë një kllaster të përbashkët në tabelë me njohuritë e fituara, po ashtu edhe i vërtetojnë apo i hedhin poshtë mendimet që i kishin dhënë në fillim për fotosintezën dhe fazat e saj.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezentime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: IX

Tema (nga
plani dymujor):
Metabolizmi

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Analizon përkufizimet, rolin, ndërlidhjen e proceseve metabolike (frymëmarrjen, fotosintezën, tajitjen, fermentimin etj.). Përshkruan procesin e frymëmarrjes te bimët ujore dhe tokësore. Shpjegon frymëmarrjen aerobe te shtazët (organizmat njëqelizorë, organizmat ujorë, organizmat tokësorë), si dhe frymëmarrjen anaerobe. Identifikon tipat e fermentimit, rolin dhe rëndësinë e tyre për metabolizmin e qenieve të gjalla. Shpjegon procesin e qarkullimit të energjisë diellore deri në formimin e ATP-së dhe rolin e ATP-së në proceset energjetike në qelizë.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II- 2 Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar, dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.

III- 7 Shfrytëzon, në mënyrë të efektshme, teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Frymëmarrja qelizore dhe prodhimi i energjisë**

Fjalët kyçe: *frymëmarrje, oksigjen, glukozë, energji-ATP*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan frymëmarrjen aerobe;
Analizon rëndësinë e frymëmarrjes aerobe;
Shpjegon procesin e qarkullimit të energjisë dhe formimin e ATP-së;*

Kriteret e suksesit:

*Trego se ku kryhet frymëmarrja aerobe te bimët dhe te disa organizma një e shumëqelizorë;
Veço produktet e fundit të frymëmarrjes aerobe;*

Defino formimin e molekulave të ATP-së.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Imagjinatë e drejtuar

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që t'i hapin librat dhe t'i shohin fotografitë, pastaj të diskutojnë se a kanë ndonjë të përbashkët zogu dhe bima në foto. Nxënësit e shohin disa minuta fotografinë dhe pastaj fillojnë diskutimin.

Leksion i avancuar

Mësimdhënësi/ja pjesën tjetër të orës e vazhdon me një leksion të avancuar, duke ua shpjeguar nxënësve përmes shembujve pikat kyçe të njësisë mësimore. U tregon nxënësve se frymëmarrja ndodh si rezultat i disa reaksioneve kimike, që shpërbëjnë molekulat ushqimore dhe çlirojnë energjinë. Frymëmarrja qelizore ndodh te bimët, te shtazët dhe te njerëzit. Shpërbërja e ushqimit mund ose nuk mund të kërkojë oksigjen. Në bimë dhe në shumë organizma, që kanë një ose më shumë qeliza, frymëmarrja aerobe ndodh në mitokondri. Këto organele përmbajnë enzimat e nevojshme për frymëmarrje. Oksigjeni shpërndahet në mitokondri dhe përdoret për të reaguar me glukozë, për ta prodhuar dyoksid karbonin, ujin dhe energjinë. Energjia kimike (një pjesë) transferohet në ATP (adenozina trifosfat), në molekulën e energjisë. Ky është një sistem akumulues dhe transportues, i cili liron energjinë pak nga pak, kur ajo nevojitet për aktivitet metabolik në qelizë. ATP-ja prodhohet në mitokondrie.

Pastaj, u kërkon që ta lexojnë njësinë mësimore të gjithë në heshtje.

Diskutim

Në pjesën e fundit të orës, nxënësit, për ta realizuar reflektimin, fillojnë të diskutojnë për atë se çfarë kanë lexuar dhe çfarë kanë mbajtur në mend.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezentime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: IX

Tema (nga
plani dymujor):
Metabolizmi

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Analizon përkufizimet, rolin, ndërlidhjen e proceseve metabolike (frymëmarrjen, fotosintezën, tajitjen, fermentimin etj). Përshkruan procesin e frymëmarrjes te bimët ujore dhe tokësore. Shpjegon frymëmarrjen aerobe te shtazët (organizmat njëqelizorë, organizmat ujorë, organizmat tokësorë), si dhe frymëmarrjen anaerobe. Identifikon tipat e fermentimit, rolin dhe rëndësinë e tyre për metabolizmin e qenieve të gjalla. Shpjegon procesin e qarkullimit të energjisë diellore deri në formimin e ATP-së dhe rolin e ATP-së në proceset energjetike në qelizë.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

II- 2 Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar, dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.

II- 7 Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.

III- 7 Shfrytëzon, në mënyrë të efektshme, teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Frymëmarrja anaerobe**

Fjalët kyçe: anaerobe, fermentim, energji-ATP, brumi i bukës.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan frymëmarrjen anaerobe;
Analizon rëndësinë e frymëmarrjes anaerobe;
Dallon fotosintezën nga frymëmarrja;*

Kriteret e suksesit:

*Përmend disa shembuj të frymëmarrjes anaerobe;
Veço produktet e fundit të frymëmarrjes anaerobe;
Krahaso fotosintezën dhe frymëmarrjen (anaerobe dhe aerobe).*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, tabela, shkumësi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Diskutim

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të diskutojnë lidhur me njohuritë që kishin fituar nga ora e kaluar për frymëmarrjen, pastaj fillojnë me njësinë e radhës.

Leksion i avancuar

Mësimdhënësi/ja pjesën tjetër të orës e vazhdon me një leksion të avancuar, duke ua shpjeguar nxënësve përmes shembujve pikat kyçe të njësisë mësimore. U tregon nxënësve se frymëmarrja, që nuk përdor oksigjenin për ta shpërbërë ushqimin kimikisht, quhet frymëmarrje anaerobe. Formimi i sasisë kryesore të ATP-së në qelizë të gjallë zhvillohet në prani të oksigjenit. Por, formimi i një pjese të ATP-së në qelizë të gjallë bëhet edhe në mungesë të oksigjenit. Një proces i tillë i formimit të ATP-së, në mungesë të oksigjenit, quhet fermentim. Në varësi të produktit përfundimtar që përfitohet nga shpërbërja anaerobe e molekulave organike (ushqimit), fermentimi dallohet, si: fermentimi alkoolik dhe fermentimi laktik. Pastaj, u kërkon nxënësve që ta lexojnë pjesën e fundit të njësisë mësimore.

Tabela e koncepteve

Në pjesën e fundit të orës, mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që ta punojnë një tabelë të koncepteve me njohuritë që i kanë marrë deri tani për frymëmarrjen anaerobe dhe dallimet në mes të frymëmarrjes dhe fotosintezës.

Tabela mund të jetë si më poshtë:

	Energjia	Lënda e parë	Produktet përfundimtare	Ku kryhen
Fotosinteza	Ruhet			
Frymëmarrja aerobe	Lëshohet			Në mitokondrie

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezentime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani dymujor):
Metabolizmi

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Emërton dhe krahason tipat e frymëmarrjes (frymëmarrje e brendshme dhe e jashtme), si dhe llojet e frymëmarrjes (trakeidale, branshiale, lëkurore, mushkërore etj) te grupet e ndryshme të shtazëve.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II- 1 Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për ta sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.

III- 7 Shfrytëzon, në mënyrë të efektshme, teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Tipat e frymëmarrjes te shtazët**

Fjalët kyçe: frymëmarrje e jashtme, frymëmarrje e brendshme, trake, mushkëri, verëza.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Identifikon tipat e frymëmarrjes, bazuar se ku bëhet këmbimi i gazeve;
 Emërton llojet e frymëmarrjes te grupet e ndryshme të shtazëve;

Kriteret e suksesit:

Krahaso frymëmarrjen e brendshme nga ajo e jashtme;
 Konstato dallimet në mes të llojeve të ndryshme të frymëmarrjes te grupet e ndryshme të shtazëve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, tabela, shkumësi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë “Di/Dua të di/Mësova” dhe kërkon që edhe nxënësit ta punojnë të njëjtën në fletoret e tyre. Në kolonën DI ata do të shkruajnë çfarë dinë për frymëmarrjen, duke ditur që ata tashmë kanë informacione, pasi deri tani është diskutuar madje edhe në klasët paraprake apo edhe nga jeta e përditshme, pasi ta plotësojnë këtë kolonë për disa minuta, u kërkon disa nxënësve që mendimet e tyre t’i shkruajnë në tabelë.

Pastaj, kërkon nga nxënësit që ta lexojnë tekstin nga libri. Pas leximit, i udhëzon ata që të shkruajnë pyetje në kolonën Dua të di, pra çfarë ata duan të dinë më shumë lidhur me tekstin që lexuan. Ndërsa për pyetjet që nxënësit kanë shkruar fillimisht, pyeten nxënësit nëse dinë të përgjigjen, pastaj nëse nuk ka përgjigje, atëherë mësimdhënësi u jep përgjigje. Kështu nxënësit plotësojnë kolonën Mësova.

Tabela mund të jetë si më poshtë:

DI	DUA TË DI	Mësova
<i>Frymëmarrja është proces i marrjes së oksigjenit dhe i lirimit të dyoksidit të karbonit.</i>	<i>Cilat janë llojet e frymëmarrjes?</i>	<i>Frymëmarrja e jashtme dhe e brendshme.</i>
	<i>Ku dallon frymëmarrja e jashtme nga ajo e brendshme?</i>	

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezentime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani dymujor):

Metabolizmi

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Përshkruan proceset metabolike, transpiracionin dhe gutacionin, si dhe rolin e rëndësishëm të ujit në turgorin e qelizës.
- Shpjegon tajitjen bimore, llojet dhe rëndësinë e tajitjes të bimëve.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I- 1 Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

II- 2 Përzgjedh informata nga burime të ndryshme për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar, dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, të shtazëve, të bimëve dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Transpirimi**

Fjalët kyçe: *avullim fiziologjik, avullim fizik, osmozë, transpirim.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan procesin e transpirimit;
 Dallon llojet e transpirimit;
 Shpjegon transportin e ujit nëpër bimë;*

Kriteret e suksesit:

*Veço organin bimor në të cilin ndodh ky proces, duke treguar funksionin e gojëzave;
 Krahaso avullimin fizik dhe atë fiziologjik;
 Vlerëso rëndësinë e osmozës për bimën.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, tabela, projektori, llaptopi, shkumësi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi, TIK.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Imagjinatë e drejtuar

Gjatë kësaj faze, mësmdhënësi/ja u kërkon nxënësve ta shikojnë në ekran një video, në të cilën bëhet fjalë për transpirimin. U kërkon nxënësve që ta përcjellin me vëmendje videon, dhe pasi ta kenë përcjellë, fillon diskutimin se çfarë kanë parë në video, çfarë është e veçanta e videos etj., duke e ditur që nxënësit kanë njohuri paraprake për këtë proces.

<https://www.youtube.com/watch?v=U4rzLhz4HHk>.

DRTA

Në vijim, mësmdhënësi/ja ua shpjegon nxënësve procedurën, e cila do të zhvillohet si më poshtë: hapet teksti në temën mësimore "TRANSPIRIMI" dhe u kërkon nxënësve që të lexojnë, më pas t'i mbyllin librat dhe të komentojnë atë që lexuan.

Mësmdhënësi/ja mund ta orientojë diskutimin me pyetje dhe kërkesa, si:

Shpjego transpirimin si proces të rëndësishëm për jetën e bimës.

Çfarë e dallon avullimin fizik nga ai fiziologjik?

Si ndodh përçimi i ujit nëpër bimë?

Kështu vepohet edhe me pjesën tjetër "Si e marrin ujin qelizat bimore?", pastaj mbyllin librat dhe fillojnë komentimin.

Edhe në këtë rast, nëse nxënësit nuk arrijnë ta mbulojnë gjithë pjesën e lexuar, ata udhëzohen përmes pyetjeve ,si : Çfarë procesi është osmoza? Çfarë rëndësie ka për bimën?

KLLASTER

Pasi nxënësit kanë lexuar dhe kanë komentuar njësinë mësimore, mësmdhënësi/ja i fton ata ta punojnë një kllaster në formë të përmbledhjes, fillimisht punojnë në grupe. Pastaj mësmdhënësi/ja i fton ata që të njëjtin ta punojnë edhe në tabelë, duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin. Kështu, do të nxjerrin vetëm pjesët kryesore të njësisë mësimore.

A

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezentime).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni për procesin e gutacionit dhe mundohuni të sillni shembuj praktikë.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMOREFusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Klasa:IX

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: IV

Tema (nga plani dymujor):

Metabolizmi

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Përshkruan proceset metabolike, transpiracionin dhe gutacionin, si dhe rolin e rëndësishëm të ujit në turgorin e qelizës.
- Shpjegon tajitjen bimore, llojet dhe rëndësinë e tajitjes te bimët.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I- 6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë, dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

II- 2 Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar, dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.

III- 7 Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORENjësia mësimore: **Gutacioni**Fjalët kyçe: *gutacion, ujë, lagështi, transpirim.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan procesin e gutacionit;
Krahason transpirimin dhe gutacionin;*

Kriteret e suksesit:

*Veço te cilat bimë është më shumë i shprehur procesi i gutacionit, duke e argumentuar atë;
Përmend një shembull të transpirimit dhe një të gutacionit.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, tabela , projektori, llaptopi, shkumësi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi, TIK.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Imagjinatë e drejtuar

Pjesës fillestare të orës mësimore i kushtohet një përsëritje e shkurtër e njësisë së kaluar, duke diskutuar konceptet kryesore që nxënësit kanë mbajtur në mend lidhur me transpirimin.

Më pas, u kërkohet nxënësve të shikojnë në ekran një video, në të cilën bëhet fjalë për gutacionin. U kërkohet nxënësve që ta përcjellin me vëmendje videon, dhe pasi ta kenë përcjellë, fillon diskutimin se çfarë kanë parë në video, çfarë është e veçanta e videos etj. Duke ditur që nxënësit kanë njohuri paraprake për këtë proces, sepse kishin pasur detyrë që të hulumtojnë, madje edhe të sjellin shembuj praktikë për këtë proces.

https://www.youtube.com/watch?v=qEa_G44Yps .

DRTA

Në vijim, mësimdhënësi/ja ua shpjegon nxënësve procedurën, e cila do të zhvillohet si më poshtë: hapet teksti në temën mësimore "GUTACIONI" dhe u kërkohet nxënësve që ta lexojnë e më pas t'i mbyllin librat dhe ta komentojnë atë që lexuan.

Mësimdhënësi/ja mund ta orientojë diskutimin me pyetje dhe kërkesa, si:

Çfarë është gutacioni? Kur mund ta vëmë re më së miri dhe pse? Çfarë rëndësie ka ai për bimën? Krahaso transpirimin dhe gutacionin, Gjeni shembuj të transpirimit dhe të gutacionit etj.

Më pas, u kërkohet edhe t'i analizojnë fotografitë nga libri dhe t'i japin komentet e tyre për to.

KLLASTER

Pasi nxënësit e kanë lexuar dhe e kanë komentuar njësinë mësimore, mësimdhënësi/ja i fton ata ta punojnë një kllaster në formë të përmbledhjes, fillimisht punojnë në grupe. Pastaj mësimdhënësi/ja i fton ata që të njëjtin ta punojnë edhe në tabelë, duke bashkëpunuar me njëri - tjetrin. Kështu, do t'i nxjerrin vetëm pjesët kryesore të njësisë mësimore, madje janë të lirë që aty edhe të vendosin krahasime në mes të transpiracionit dhe gutacionit si procese që ndodhin në bimë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore. Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni për tipat e tajitjes te shtazët dhe te njeriu.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani dymujor):

Metabolizmi

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Emërton, vlerëson dhe analizon ndërtimin, rolin dhe rëndësinë e produkteve metabolike (proteinave, sheqernave yndyrave, vitaminave, enzimeve etj.), si dhe rrugët e metabolizmit të tyre.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

III- 7 *Shfrytëzon, në mënyrë të efektshme, teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.*

IV- 1 . *Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.*

VI- 1. *Praktikon të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë në situata konkrete jetësore të përditshme, qoftë në klasë, qoftë në shkollë apo gjetiu (si: gjatë diskutimit, respektimit të mendimit të tjetrit etj).*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Ndërtimi dhe roli i lëndëve organike**

Fjalët kyçe: *materie organike, ndërtuese, esenciale, energji.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Shpjegon rolin e produkteve metabolike;

Vlerëson rëndësinë e produkteve metabolike për organizmin e njeriut;

Kriteret e suksesit:

Numëro produktet metabolike;

Veço funksionin e produkteve metabolike;

Analizo rrugët e metabolizmit të tyre.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi/ja e fillon orën mësimore, duke i pyetur nxënësit se çfarë dinë për proteinat, vitaminat, enzimet apo yndyrat.

Nxënësit mendojnë për pak minuta dhe fillojnë t'i shpalosin mendimet e tyre.

GRUPET E EKSPERTËVE

Mësimdhënësi/ja zgjedh të punojë përmes grupeve të ekspertëve, nxënësit ndahen në grupe pune dhe cakton numrat nga 1-6 për secilin nxënës të çdo grupi, orientohet secili nxënës të lexojë në libër nga një pjesë.

1-shat lexojnë për karbohidratet;

2-shat lexojnë për yndyrat;

3-shat lexojnë për enzimet;

4-shat lexojnë për fibrat;

5-shat lexojnë për vitaminat;

6-shat lexojnë për proteinat.

Pasi nxënësit ta kenë kuptuar pjesën e tyre, fton që në një grup të bashkohen numrat 1 nga të gjitha grupet, pastaj në grupin tjetër numrat 2, në grupin tjetër numrat 3, në grupin tjetër numrat 4, në grupin e fundit numrat 5. Kështu, të bashkuar fton nxënësit të diskutojnë në mes tyre lidhur me atë çfarë lexuan, sa kanë mbajtur në mend, dhe këto informacione t'i shkëmbejnë me njëri tjetrin. Pas pak minutash, fton nxënësit të kthehen në grupet e tyre fillestare dhe aty të diskutojnë prapë për atë çfarë mbajtën në mend secili për pjesën e tyre.

DISKUTIMI

Pasi të mbarojë diskutimi për grupin, fillon diskutimi i përgjithshëm, mësimdhënësi/ja i fton nxënësit që më parë i kishin lexuar karbohidratet ta fillojnë diskutimin, pastaj po i njëjti nxënës në fund bën një pyetje për atë se çfarë ka mësuar ai, dhe përgjigjet i japin nxënësit që më parë nuk e patën për detyrë të lexojnë për karbohidratet, kështu dimë se sa kemi arritur t'i transmetojmë njohuritë të nxënësit përmes nxënësve. Kështu vazhdohet edhe me pjesët tjera, si me yndyrat, vitaminat, enzimet etj. Dhe në këtë mënyrë arrijmë të bëjmë një analizë të produkteve metabolike, duke specifikuar secilën nga to.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyses, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: IX

Tema (nga plani dymujor):

Cikli jetësor i organizmave

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Përshkruan procesin e formimit të qelizave seksuale.
- Analizon ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet mitozës dhe mejozës.
- Shpjegon ndyshimin e ADN-së dhe të kromozomeve gjatë ndarjes qelizore.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

I- 1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

II- 1. Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për ta sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.

III- 7 Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mitoza

Fjalët kyçe: kromozom, diploid, haploid, mitozë, ndarje e materialit gjenetik

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Përshkruan ndarjen mitotike;

Shpjegon ndryshimin e ADN-së dhe të kromozomeve gjatë kësaj ndarjeje;

Kriteret e suksesit:

Numëro fazat nëpër të cilat kalon kjo ndarje;

Veço ndryshimet e ADN-së dhe të kromozomeve gjatë ndarjes qelizore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, interneti, lloptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi, TIK.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi/ja e fillon orën mësimore, duke pyetur nxënësit se çfarë dinë për "mitozën", a kanë dëgjuar më parë për të.

Nxënësit mendojnë për pak minuta dhe fillojnë t'i shpalosin mendimet e tyre.

LEKSION I AVANCUAR

Mësimdhënësi/ja pjesën tjetër të orës mësimore e realizon, duke paraqitur te nxënësit pjesët kryesore të njësisë mësimore dhe e fillon, duke ua shfaqur një video për mitozën: [youtube.com/watch?v=DwAFZb8juMQ](https://www.youtube.com/watch?v=DwAFZb8juMQ).

Pastaj, sqaron më në detaje se cikli qelizor, ku formohen dy qeliza të reja bija identike nga ndarja e qelizës mëmë, quhet mitozë. Ndodh në të gjitha qelizat trupore (somatic). Qelizat trupore kanë një tufë (numër) të dyfishtë "diploid" të kromozomeve. Kështu, qelizat e trupit tonë kanë 23 çifte të kromozomeve, prej të cilave 22 prej tyre janë të njëjta te burrat dhe te gratë, një çift (kromozome seksuale) është i ndryshëm te burrat dhe te gratë, prej kombinimit të tyre varet përcaktimi i gjinisë - seksit. Ndarja qelizore (mitoza) bën që organizmat të rriten, që qelizat e dëmtuara dhe të vjetra të zëvendësohen me të reja, të zëvendësojnë pjesë të humbura dhe të prodhojnë pasardhës identikë. Organizmi bimor, shtazor apo njeriu, kur rritet, përbëhet nga miliarda qeliza. Në fund, mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që ta lexojnë njësinë mësimore në heshtje, e pastaj të fillojë diskutimi.

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit ta kenë dëgjuar mësimdhënësin/en dhe ta kenë lexuar njësinë mësimore nga libri, tani janë në gjendje të diskutojnë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Krijoni me mjete shtëpie modelin e kromozomeve dhe provoni ta ilustroni ndarjen mitotike.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Klasa: IX

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: IV

Tema (nga plani dymujor):
Cikli jetësor i organizmave

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Përshkruan procesin e formimit të qelizave seksuale.
- Analizon ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet mitozës dhe mejozës.
- Shpjegon ndryshimin e ADN-së dhe të kromozomeve gjatë ndarjes qelizore.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I- 1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

II- 1. Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për ta sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.

III- 7 Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mejoza

Fjalët kyçe: kromozom, reduktim, kromozome, ndarje, qeliza bija

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Përshkruan ndarjen mejotike;

Shpjegon ndryshimin e ADN-së dhe të kromozomeve gjatë kësaj ndarjeje;

Krahason ndarjen mejotike dhe mitotike;

Kriteret e suksesit:

Listo fazat nëpër të cilat kalon kjo ndarje;

Veço ndryshimet e ADN-së dhe të kromozomeve gjatë ndarjes qelizore;

Gjej dallimet dhe të përbashkëtat në mes të ndarjes mejotike dhe mitotike.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, interneti, llaptopi, fotografi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi, TIK, Matematikë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Stuhi mendimesh


Mësimdhënësi/ja e fillon orën mësimore, duke i pyetur nxënësit se çfarë dinë për “mejozën”, a kanë dëgjuar më parë për të.

Nxënësit mendojnë për pak minuta dhe fillojnë t’i shpalosin mendimet e tyre.

LEKSION I AVANCUAR

Mësimdhënësi/ja e realizon pjesën tjetër të orës mësimore, duke paraqitur te nxënësit pjesët kryesore të njësisë mësimore dhe fillon, duke ua shfaqur një fotografi, e ndërkohë sa sqaron ua paraqet edhe një video të shkurtër, për procesin në fjalë.

Mejoza




<https://www.youtube.com/watch?v=nMEyeKQClqI>

Në fund të sqarimeve, mësimitdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që ta lexojnë njësinë mësimore në libër.

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit ta kenë lexuar njësinë mësimore nga libri, tani janë në gjendje të diskutojnë, ndërsa mësimitdhënësi/ja i udhëzon ata që ta bëjnë një krahasim me mitozën, duke gjetur edhe ngjashmëritë.

Po ashtu, i pyet ata edhe më në detaje për kromozomet. Për ta konkretizuar pyetjen, mësimitdhënësi/ja paraqet në ekran një fotografi si më poshtë.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni për ndarjen mejotike.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani dymujor):

Cikli jetësor i organizmave

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Shpjegon konceptet dhe përkufizimet kryesore në procesin e një cikli jetësor.
- Analizon shembuj të ciklit jetësor te bota bimore.
- Shpjegon ciklin e zhvillimit të bimëve me spore.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II- 7. Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.

III- 2. Shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burimet e tjera gjatë ndërtimit të një ideje ose projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Cikli jetësor i bimëve me spore**

Fjalët kyçe: *gametofit, sporofit, protonem, operkulum, zigotë*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Shpjegon ciklin jetësor të myshqeve;
 Përshkruan ndërtimin e sporofitit;*

Kriteret e suksesit:

*Përshruaj fazat e ciklit jetësor të myshqeve;
 Krahaso protonemën me një myshk të rritur.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, interneti, llaptopi, fotografitë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata

jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi, TIK.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Imagjinatë e drejtuar


Mësimdhënësi/ja e fillon orën mësimore, duke paraqitur para nxënësve një video si më poshtë: https://www.youtube.com/watch?v=wL0_fOBCA0, u kërkon nxënësve që ta përcjellin me vëmendje videon, dhe pasi ta kenë përcjellë, fillon diskutimin se çfarë kanë parë në video, çfarë është e veçanta e videos etj.

MËSIM I PËRQENDRUAR NË ARGUMENTE

Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që t'i hapin librat dhe ta lexojnë njësinë mësimore. Pasi ta kenë lexuar, nxënësit me vëmendje përcjellin pyetjet e mësimdhënësit/es dhe në bashkëpunim me grupin përgjigjen, kështu mund të realizohet diskutimi.

P.sh.:

1. Sa breza dallohen në ciklin jetësor të myshqeve dhe përmend cilët janë ata?
2. Çfarë kupton me riprodhim seksual dhe çfarë me pllenim?
3. Ç'është protonema dhe çka zhvillohet nga ajo?
4. Përshkruaj ndërtimin e sporofitit.
5. Përshkruaj fotografinë e dhënë.
6. Tregoni se çfarë është kaliptra.



RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit ta kenë lexuar njësinë mësimore nga libri, tani janë në gjendje të diskutojnë, dhe diskutimi fillon me pyetjet e dhëna më lart, mësimdhënësi/ja zgjedh një nxënës vullnetar për t'u përgjigjur në pyetjen e parë, pastaj nxënësit e tjerë janë të lirë t'i bëjnë edhe një pyetje tjetër, pastaj ai nxënës zgjedh një nxënës tjetër për t'u përgjigjur në pyetjen e dytë, e kështu vazhdohet derisa të mbarojë i gjithë diskutimi.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyses, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni për ciklin jetësor të bimëve me farë.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani dymujor):
Cikli jetësor i organizmave

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
 Shpjegon ciklin e zhvillimit të bimëve me farë. Shpjegon procesin e rritjes dhe zhvillimin e bimëve me farë, dhe faktorët që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e bimëve.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I 6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë, dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

III- 7 Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

IV. 1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur, në forma të ndryshme të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriu, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Cikli jetësor i bimëve me farë**

Fjalët kyçe: *zigotë, cikël jetësor, bimë misri, pllenim, ujë, oksigjen*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Shpjegon ciklin jetësor të bimës së misrit;

Numëron faktorët që ndikojnë në rritjen dhe në zhvillimin e bimëve me farë;

Kriteret e suksesit:

Përshkruaj fazat e ciklit jetësor të bimëve me farë;

Veço rëndësinë e ujit dhe të dritës në rritjen e bimëve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore realizohet përmes teknikës Di, Dua të di, Mësova.

Në kolonën Di shkruajnë fillimisht se çfarë dinë për njësinë mësimore, bazuar në njohuritë e tyre paraprake, hulumtimin e detyrës së shtëpisë, pastaj e lexojnë njësinë mësimore në libër dhe shtojnë pyetje se çfarë duan

të dinë, ndërsa në kolonën Mësova shkruajnë se çfarë kanë mësuar.

DI	DUA TË DI	MËSOVA

Deri sa ta punojnë kolonën Mësova, mësimsdhënësi/ja u kërkon nxënësve t'i komentojnë fotografitë nga libri.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani

dymujor):

Cikli jetësor i organizmave

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Analizon shembuj të ciklit jetësor të bota shtazore.
- Vlerëson rolin e shumimit në zhvillimin e botës së gjallë.
- Hulumton dhe vlerëson fazat kryesore të zhvillimit embrional tek ujëtokësorët (në shembullin e bretkosës) dhe te shpendët (në shembullin e zogut të pulës).
- Krahason fazat e zhvillimit të drejtpërdrejtë dhe me metamorfozë të dy përfaqësues të kurrizorëve.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-8 . *Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën, duke u përgjigjur dhe duke veçuar informatën kryesore.*

III- 7 *Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Cikli jetësor i shtazëve**

Fjalët kyçe: *metamorfozë, bretkosë, cikël jetësor*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Shpjegon ciklin jetësor të ujëtokësorëve;
 Krahason zhvillimin e peshqve dhe të ujëtokësorëve;*

Kriteret e suksesit:

*Përshkruaj fazat e zhvillimit të bretkosës;
 Dallo ciklin jetësor të ujëtokësorëve dhe të peshqve.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, interneti, llaptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, TIK, Gjeografi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

*Gjatë kësaj faze, mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve ta shikojnë në ekran një video, në të cilën bëhet një përshkrim i botës shtazore, më saktë bëhet fjalë për ciklin jetësor të bretkosës. U kërkon nxënësve që ta përcjellin me vëmendje videon, dhe pasi ta kenë përcjellë, fillon diskutimin se çfarë kanë parë në video, çfarë është e veçanta e videos etj:
https://www.youtube.com/watch?v=RQn3_LCbl-Y.*

LEKSION I AVANCUAR

Mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve në pika të shkurtra karakteristikat dalluese të peshqve dhe të ujëtokësorëve. Tregon se te grupet e ndryshme të shtazëve ekzistojnë dallime, por edhe ngjashmëri në zhvillimin embrional të tyre. Te shumica e peshqve dhe te ujëtokësorët, pllenimi është i jashtëm (bëhet në ujë), pra vezët dhe spermatozoidet “shkrihen” jashtë trupit të femrës. Te peshqit dhe te ujëtokësorët, embrioni zhvillohet në vezë, jashtë trupit. Larvat e peshqve dhe të ujëtokësorëve, me kalimin e kohës zhvillohen në individë të rritur, ky proces edhe te insektet quhet metamorfozë. Në fund, mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që ta lexojnë në heshtje njësinë mësimore dhe pastaj ta punojnë një kllaster.

KLLASTER

Pasi nxënësit ta kenë lexuar njësinë mësimore në heshtje, mësimdhënësi/ja i fton ata ta punojnë një kllaster në formë të përmbledhjes, fillimisht punojnë në grupe. Pastaj, mësimdhënësi/ja i fton ata që të njëjtin ta punojnë edhe në tabelë, duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni për ciklin jetësor të shpendëve

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: IX

Tema (nga plani

dymujor):

**Cikli jetësor i
organizmave**

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Vlerëson rolin e shumimit në zhvillimin e botës së gjallë.
- Hulumton dhe vlerëson fazat kryesore të zhvillimit embrional tek ujëtokësorët (në shembullin e bretkosës) dhe te shpendët (në shembullin e zogut të pulës).
- Hulumton disa grupe kurrizorësh, të cilët zhvillimi embrional kryhet në ambientin e jashtëm, kurse te të tjerët në brendi të trupit.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-8 *Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën, duke u përgjigjur dhe duke veçuar informatën kryesore.*

III- 7 *Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Cikli jetësor i shpendëve**

Fjalët kyçe: *vezë, pulë, zvarranik, shpend, cikël jetësor*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Shpjegon ciklin jetësor të zvarranikëve dhe të shpendëve;

Krahason zhvillimin e zvarranikëve me atë të shpendëve;

Kriteret e suksesit:

Përshkruaj fazat e zhvillimit të zogut të pulës;

Dallo ciklin jetësor të zvarranikëve nga ai i shpendëve, duke u munduar ta krahasosh me ciklin jetësor të ujëtokësorëve dhe të peshqve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, interneti, llaptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, TIK, Matematikë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Gjatë kësaj faze, mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të shikojnë në ekran një video, në të cilën shihet cikli i zhvillimit të shpendëve. U kërkon nxënësve që ta përcjellin me vëmendje videon, dhe pasi ta kenë përcjellë, fillon diskutimin se çfarë kanë parë në video, çfarë është e veçanta e videos etj.: <https://www.youtube.com/watch?v=dyZjCw5RI2Y>

LEKSION I AVANCUAR

Mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve në pika të shkurtra karakteristikat dalluese të zvarranikëve dhe të shpendëve. Tregon se zvarranikët dhe zogjtë zhvillohen nga vezët e bëra nga ta. Te zvarranikët dhe te zogjtë, embrioni zhvillohet brenda vezës, jashtë trupit. Zhvillimi i pulës nuk fillon derisa të inkubohet veza e pllenuar. Veza e pulës duhet të inkubohet për 21 ditë që të zhvillohet në një zog. Aty ushqehet me të verdhën e vezës, derisa të arrijë ta çajë lëvozhgën e vezës dhe të dalë jashtë individ i ri, i cili u ngjan prindërve të tij. Në fund u kërkon nxënësve që ta lexojnë njësinë mësimore.

KLLASTER

Pasi nxënësit ta kenë lexuar njësinë mësimore në heshtje, mësimdhënësi/ja i fton ata ta punojnë një kllaster në formë të përmbledhjes, fillimisht punojnë në grupe. Pastaj, mësimdhënësi/ja i fton ata që të njëjtin ta punojnë edhe në tabelë, duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni rreth frytnimit artificial te shtazët dhe te bimët.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: IX

Tema (nga plani

dymujor):

Cikli jetësor i organizmave

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Shpjegon konceptin e frytnimit artificial.
- Hulumton disa grupe kurrizorësh, të cilët zhvillimi embrional kryhet në ambientin e jashtëm, kurse të tjerët në brendi të trupit.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I- 5. *Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshetuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.*

III- 7 *Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.*

II 8. *Identifikon, me anë të krahasimit, dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak - pasojë midis këtyre dukurive.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Pllenimi artificial**

Fjalët kyçe: *frytnim artificial, ngjizje, pasardhës, delja Dolly*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Shpjegon konceptin “frytnim artificial”;
Krahason procesin e frytnimit artificial të bimët dhe të shtazët;
Tregon rëndësinë e frytnimit artificial;

Kriteret e suksesit:

Analizo procesin e frytnimit artificial;

*Përshkruaj klonimin e deles Dolly;
Vlerëso rëndësinë e frynimit artificial.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, interneti, llaptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, TIK, Kimi, Matematikë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

PARASHIKIMI ME TERMA PARAPRAKË – (e modifikuar)

Gjatë kësaj faze, mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve t'i shkëmbejnë detyrat e shtëpisë me njëri - tjetrin. Pastaj, kërkon që disa nga nxënësit të lexojnë çfarë ka shkruar shoku apo shoqja. Kështu vepron për disa herë.

TABELA E KONCEPTEVE

Pasi kuptojmë se nxënësit në punimet e shtëpisë janë përpjekur të gjejnë disa informacione për frynimin artificial, disa nga to mund edhe të mos jenë të sakta, kështu nxënësit kanë mundësinë që tani, pas leximit, t'i vetëvlerësojnë gjetjet e tyre. Mësimdhënësi/ja i udhëzon ata se duhet ta lexojnë në heshtje njësinë mësimore, e pastaj ta plotësojnë tabelën e koncepteve në bashkëpunim me grupin, si më poshtë:

Koncepti	Shpjegimi
Pllenimi artificial te shtazët	
Pllenimi artificial te bimët	
Klonimi	
Rëndësia e pllenimit artificial për botën bimore	
Rëndësia e pllenimit artificial për botën shtazore	

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit ta kenë plotësuar tabelën e koncepteve, mësimdhënësi/ja fton nxënësit për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve. Ftohen nxënësit që t'i interpretojnë me fjalë, me shkrim/me gojë konceptet apo proceset e caktuara, duke i ilustruar me shembuj konkretë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni për frynimin artificial te njeriu.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani

dymujor):

**Cikli jetësor i
 organizmave**

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Hulumton dhe përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet gjatë procesit të zhvillimit embrional tek organizmat e ndryshëm.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

I- 5. *Prezenton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërrshetur format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.*

III- 7 *Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.*

II 8. *Identifikon, me anë të krahasimit, dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak - pasojë midis këtyre dukurive.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriu, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Pllenimi artificial te njeriu**

Fjalët kyçe: *frytnim artificial, ngjizje, banka gjenetike*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Shpjegon konceptin: banka gjenetike;

Tregon rëndësinë e frytnimit artificial te njeriu;

Kriteret e suksesit:

Veço rëndësinë e bankës gjenetike për njerëzimin;

Vlerëso rëndësinë e frytnimit artificial te njeriu.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, interneti, lloptopi.

Lidhja me e lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, TIK, Kimi, Matematikë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi/ja e fillon orën mësimore, duke i pyetur nxënësit se çfarë dinë për “frytnimin artificial te njeriu”, a kanë dëgjuar më parë për të. Sigurisht, secili nga ta do të ketë përgjigje, sepse tashmë kishin për detyrë shtëpie të hulumtonin për frytnimin artificial te njeriu. Nxënësit mendojnë për pak minuta dhe fillojnë t’i shpalosin mendimet e tyre.

PYETJE DHE PËRGJIGJE, PUNË NË GRUPE

Mësimdhënësi/ja e vazhdon orën mësimore përmes udhëzimeve të diferencuara, duke kërkuar prej nxënësve që ta lexojnë njësinë mësimore në heshtje. Pastaj, i shkruan disa pyetjet si më poshtë në tabelë. I udhëzon nxënësit që të mendojnë se si do t’u përgjigjeshin pyetjeve. Nxënësit diskutojnë në grupe, duke u munduar të gjejnë përgjigje sa më të sakta.

Pyetjet.

- 1. Përshkruaj pllenimin artificial.*
- 2. Dallo pllenimin artificial nga ai natyror.*
- 3. Trego përparësitë dhe mangësitë e pllenimit artificial.*
- 4. Shpjego kur e bëjnë gratë pllenimin artificial.*
- 5. Cilat metoda kemi për ta ruajtur biodiversitetin?*

Udhëzon edhe nxënësit që të shkruajnë pyetje të tjera, në mënyrë që diskutimi të zgjerohet më shumë.

DISKUTIM

Pasi nxënësit ta kenë lexuar njësinë mësimore nga libri, tani janë në gjendje të diskutojnë, dhe diskutimi fillon me pyetjet e dhëna më lart. Mësimdhënësi/ja zgjedh një nxënës vullnetar për t’u përgjigjur në pyetjen e parë, pastaj nxënësit e tjerë janë të lirë t’i bëjnë edhe një pyetje tjetër, më pas ai nxënës zgjedh një nxënës tjetër për t’u përgjigjur në pyetjen e dytë, e kështu vazhdohet derisa të mbarojë i gjithë diskutimi.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyses, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: IX

Tema (nga plani dymujor):

Trashëgimia te njeriu,

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Shpjegon konceptet dhe përkufizimet themelore të trashëgimisë te bota e gjallë, me theks trashëgiminë te njeriu.
- Përshkruan ndërtimin e bërthamës qelizore. Shpjegon materialin bërthamor, me theks ndërtimin e kromozomeve;

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

I 6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë, dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

II- 2 Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar, dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.

III- 7 Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Trashëgimia dhe mjedisi

Fjalët kyçe: pasardhës, bërthamë, kromozom

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Shpjegon konceptet dhe përkufizimet themelore të trashëgimisë te bota e gjallë, me theks trashëgiminë te njeriu; Përshkruan ndërtimin e bërthamës qelizore; Shpjegon ndërtimin e materialit bërthamor, më saktë të kromozomeve;

Kriteret e suksesit:

Veço rëndësinë e trashëgimisë për njerëzimin;

*Analizo ndërtimin e bërthamës qelizore;
Trego ndërtimin e materialit bërthamor.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, interneti, llaptopi.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, TIK, Kimi, Matematikë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Imagjinatë e drejtuar

Në fillim të kësaj ore, mësimitdhënësi/ja u kërkon nxënësve t'i shikojnë fotografitë, të cilat më parë i ka printuar dhe i ka vendosur nëpër grupe, si më poshtë. U kërkon nxënësve që të përcjellin me vëmendje, dhe pasi t'i kenë analizuar fotografitë, fillon diskutimin se çfarë kanë parë, çfarë është domethënia e fotografisë etj.



MINIGRUPET E EKSPERTËVE

Mësimdhënësi/ja zgjedh të punojë përmes grupeve të ekspertëve (grup i vogël), nxënësit ndahen në grupe pune dhe cakton numrat nga 1-3 për secilin nxënës të çdo grupi, orientohet në libër të lexojë secili nxënës nga një pjesë.

1-shat lexojnë për trashëgiminë;

2-shat lexojnë për bërthamën;

3-shat lexojnë për kromozomet.

Pasi nxënësit ta kenë kuptuar pjesën e tyre, fton që në një grup të bashkohen numrat 1 nga të gjitha grupet, pastaj në grupin tjetër numrat 2, në grupin tjetër numrat 3. Kështu, të bashkuar fton nxënësit të diskutojnë në mes tyre lidhur me atë çfarë lexuan, sa kanë mbajtur në mend, dhe këto informacione t'i shkëmbejnë me njëri- tjetrin. Pas pak minutash, fton nxënësit të kthehen në grupet e tyre fillestare dhe aty të diskutojnë prapë për atë se çfarë mbajtën në mend secili për pjesën e tyre.

DISKUTIMI

Pasi të mbarojë diskutimi për grupin, fillon diskutimi i përgjithshëm. Mësimdhënësi/ja i fton nxënësit që më parë kishin lexuar për trashëgiminë ta fillojnë diskutimin, pastaj po i njëjti nxënës në fund bën një pyetje për atë se çfarë ka mësuar ai dhe përgjigjet i japin nxënësit që më parë nuk e patën për detyrë të lexojnë për trashëgiminë , kështu dimë se sa kemi arritur t'i transmetojmë njohuritë te nxënësit përmes nxënësve. Në këtë mënyrë vazhdohet edhe me pjesët e tjera si me bërthamën, ashtu edhe me kromozomet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Me mjetet tuaja shtëpiake ndërtoni një qelizë, prej saj veçoni bërthamën dhe materialin bërthamor (kromozomet).

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani

dymujor):

Trashëgimia te njeriu

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Emërton katër bazat azotike të ADN-së. Shpjegon ADN-në dhe dyfishimin (replikimin) e ADN-së;

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

I- 1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

II 1. Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për ta sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.

II- 7 Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **AND-ja, molekulë e jetës**

Fjalët kyçe: ADN, gjen, proteinë, adeninë, timinë, guaninë, citozinë.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Shpjegon ndërtimin e ADN-së;

Emërton bazat azotike të ADN-së;

Shpjegon dyfishim e AND-së

Kriteret e suksesit:

Analizo ndërtimin e AND-së (bazohu në model);

Trego procesin e dyfishimit të AND-së.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, interneti, llaptopi, model ADN.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, TIK, Kimi, Matematikë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

KLLASTER

Në fillimi të kësaj ore, mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve t'i diskutojnë dhe t'i prezentojnë detyrat e shëpisë, duke kontribuar në krijimin e një kllasteri. Pra, kishin për detyrë që me mjetet shtëpiake të ndërtojnë një qelizë, prej saj të veçojnë bërthamën dhe materialin bërthamor (kromozomet). Ndërkohë mësimdhënësi/ja paraqet në ekran edhe një fotografi të tillë, në rast se detyrat nuk janë punuar.




TABELA E KONCEPTEVE

Pasi kuptojmë se nxënësit në punimet e shtëpisë janë përpjekur të gjejnë disa informacione për kromozomet dhe pastaj edhe për ADN-në, disa nga to mund edhe të mos jenë të sakta, kështu kanë mundësinë nxënësit që tani, pas leximit, t'i vetëvlerësojnë gjetjet e tyre. Mësimdhënësi/ja i udhëzon ata se duhet ta lexojnë në heshtje njësinë mësimore, e pastaj ta plotësojnë tabelën e koncepteve, si më poshtë:

Shfrytëzon edhe modelin e strukturës së AND-së për demonstrim.

Koncepti	Shpjegimi
ADN	
Përbërja e ADN-së	
ADN-ja vendos cilat proteina të formohen	
AND-ja përcjell jetën më tutje	
Gjenet	

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit ta kenë plotësuar tabelën e koncepteve, mësimmshënësi/ja fton nxënësit për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve. Ftohen nxënësit që t'i interpretojnë me fjalë, me shkrim/me gojë konceptet.

Gjithashtu, mësimmshënësi/ja paraqet një varg me baza azotike dhe kërkon nga nxënësit që ta përshtatin vargun tjetër (shembull):

ATTGCCTTTATATGCGACGCGCATAT

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Klasa: IX

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: IV

Tema (nga plani

dymujor):

Trashëgimia te njeriu

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Vlerëson rolin e kromozomeve në trashëgimi. Vlerëson rolin e trashëgimisë te njeriu.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

I-8. *Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën, duke u përgjigjur dhe duke veçuar informatën kryesore.*

II 8. *Identifikon, me anë të krahasimit, dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak - pasojë midis këtyre dukurive.*

III- 7. *Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Mjedisi ka ndikim në paraqitjen e vetive**

Fjalët kyçe: *mjedisi, veçori, trashëgimi*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Shpjegon ndikimet e mjedisit në paraqitjen e vetive të organizmave;
Argumenton se mjedisi ka ndikim në shfaqjen e vetive të patrashëguara;*

Kriteret e suksesit:

*Vlerëso rolin e trashëgimisë dhe ndikimin e mjedisit;
Jep shembuj të ndikimit të mjedisit.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, tabela, fletore, laps.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, TIK, Gjeografi, Edukatë qytetare.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

DI/DUA TË DI/MËSOVA

Mësimdhënësi/ja zgjedh që orën mësimore ta realizojë me teknikën “Di/Dua të di/ Mësova” dhe kërkon që edhe nxënësit ta punojnë të njëjtën në fletoret e tyre. Në kolonën Di ata do të shkruajnë çfarë dinë për rolin e mjedisit në paraqitjen e vetive. Pasi ta plotësojnë këtë kolonë për disa minuta, u kërkon disa nxënësve që mendimet e tyre t’i shkruajnë në tabelë.

Pataj, kërkon nga nxënësit që ta lexojnë tekstin nga libri. Pas leximit, i udhëzon ata që të shkruajnë pyetje në kolonën Dua të di, pra çfarë ata duan të dinë më shumë lidhur me tekstin që lexuan. Ndërsa për pyetjet që nxënësit kanë shkruar fillimisht, pyeten nxënësit nëse dinë të përgjigjen, pastaj nëse nuk ka përgjigje, atëherë mësimdhënësi u jep përgjigje. Kështu nxënësit plotësojnë kolonën Mësova.

<i>DI</i>	<i>DUA TË DI</i>	<i>MËSOVA</i>

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani dymujor):
Trashëgimia te njeriu

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
 Arsyeton dallimin në numrin e kromozomeve në qelizat trupore dhe në qelizat seksuale (gamete). Shpjegon shumimin e qelizave te njeriu (krahason mitozën dhe mejozën).

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

I- 2. Përshkruan një ngjarje, të dhënë si detyrë, të lexuar ose të dëgjuar më parë, në formë verbale, vizuale ose me shkrim, duke ruajtur rrjedhën logjike të saj.

III- 5. Paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti, duke e sqaruar dhe duke e argumentuar më pas këtë para të tjerëve.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Gjenet kontrollojnë zhvillimin e vetive të trashëguara tek individët**

Fjalët kyçe: *Gjen, veçori, trashëgimi, kromozome, kontroll.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Argumenton numrin e kromozomeve në qelizat trupore (me shembuj);
 Shpjegon se gjenet trashëgohen brez pas brezi;*

Kriteret e suksesit:

*Veço numrin e kromozomeve trupore te llojet e ndryshme shtazore;
 Gjej ndonjë veçori të trashëguar nga prindërit e prindërve tuaj.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, TIK, Kimi, Matematikë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë titullin: “Gjenet kontrollojnë zhvillimin e vetive të trashëguara tek individët” dhe u kërkon nxënësve t’i shpalosin njohuritë e tyre lidhur me temën, duke u bazuar në njohuritë paraprake. Pasi kanë menduar në heshtje, u jep fjalën nxënësve të shprehin atë çfarë kanë menduar, mendimet e tyre mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë, pa i mohuar apo pa i pohuar ato.

DRTA

Në vijim, mësimdhënësi/ja ua shpjegon nxënësve procedurën, e cila do të zhvillohet si më poshtë: hapet teksti në temën mësimore “Gjenet kontrollojnë zhvillimin e vetive të trashëguara tek individët” dhe u kërkon nxënësve që të lexojnë me paragrafe, pra sipas leximit të drejtuar DRTA, duke realizuar kështu realizimin e kuptimit.

SHKRIM I LIRË- ESE

Pasi nxënësit ta kenë mbaruar leximin dhe të kenë sqaruar çdo paqartësi, ata i udhëzojnë mësimdhënësi të shkruajnë nga një ese të shkurtër lidhur me temën dhe çfarë mbajtën në mend. (ose gjen detyra të ndryshme)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyese, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni për Gregor Mendelin dhe gjetjet e tij.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: IX

Tema (nga plani

dymujor):

Trashëgimia te njeriu

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Shpjegon kryqëzimin dhe rregullat e trashëgimisë bazuar në Ligjet e Mendelit.
- Zbaton parimet e trashëgimisë së Mendelit për të bërë parashikime lidhur me paraqitjen e cilësive në pasardhës.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I- 5. Prezenton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërrshetur format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.

II- 2 Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar, dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.

III- 2. Shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burimet e tjera gjatë ndërtimit të një ideje ose projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Gregor Mendeli, një studius i madh i trashëgimisë**

Fjalët kyçe: *trashëgimi, kromozome, dominant, recesiv*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Shpjegon hulumtimet e Gregor Mendelit;
Sqaron termat dominant dhe recesiv;*

Kriteret e suksesit:

*Vlerëso hulumtimin dhe eksperimentet e Mendelit;
Gjej veçoritë dominante të trashëguara nga brezi i tretë.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, TIK, Kimi, Matematikë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

DI/DUA TË DI/MËSOVA

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë “Di/Dua të di/ Mësova” dhe kërkon që edhe nxënësit ta punojnë të njëjtën në fletoret e tyre. Në kolonën Di ata do të shkruajnë çfarë dinë për studiuesin e trashëgimisë, Gregor Mendelin, pasi edhe kishin për detyrë të hulumtojnë në shtëpi. Pasi ta plotësojnë këtë kolonë për disa minuta, u kërkon disa nxënësve që mendimet e tyre t’i shkruajnë në tabelë.

Pataj, kërkon nga nxënësit që ta lexojnë tekstin nga libri. Pas leximit, i udhëzon ata që të shkruajnë pyetje në kolonën Dua të di, pra çfarë ata duan të dinë më shumë lidhur me tekstin që lexuan. Ndërsa për pyetjet që nxënësit kanë shkruar fillimisht, pyeten nxënësit nëse dinë të përgjigjen, pastaj nëse nuk ka përgjigje, atëherë mësimdhënësi u jep përgjigje. Kështu, nxënësit plotësojnë kolonën Mësova.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Gregor Mendel ishte një murg austriak. Ai studioi matematikën dhe historinë e natyrës. Mendeli ishte i interesuar për botanikë.	<i>Cilat janë ligjet e Mendelit?</i>	

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani

dymujor):

Trashëgimia te njeriu

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Shpjegon kryqëzimin dhe rregullat e trashëgimisë bazuar në Ligjet e Mendelit.
- Zbaton parimet e trashëgimisë së Mendelit për të bërë parashikime lidhur me paraqitjen e cilësive në pasardhës.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

I 1. *Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.*

II- 1. *Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për ta sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Ligjet e Gregor Mendelit - bazat e trashëgimisë**

Fjalët kyçe: *hibrid, gjeneratë, kryqëzim, dominante, recesive.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Shpjegon ligjet e Mendelit;
 Sqaron trashëgiminë e ndërmjetme;
 Vlerëson rëndësinë e kryqëzimeve;*

Kriteret e suksesit:

*Realizo shembuj të ngjashëm nga ata të Mendelit, bazuar në ligjet e tij;
 Argumento me shembuj rëndësinë e trashëgimisë së ndërmjetme.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, laptopi, interneti, fotografi, projektor (TV).

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, TIK, Kimi, Matematikë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Stuhi mendimesh



Gjatë kësaj faze mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve t'i shpalosin mendimet e tyre lidhur me ligjet e Mendelit, pasi për të ata kishin pasur detyrë të lexojnë e të hulumtojnë.


DITARI DYPJESËSH

Mësimdhënësi/ja organizon në dyshe grupet e punës. Udhëzon nxënësit se çfarë duhet të lexojnë, duke mbajtur shënime, dhe të interpretojnë, duke plotësuar modelin e ditarit dypjesësh, si në tabelë. Në një rën anë do t'i shkruajnë konceptet kryesore, e përkrah saj do t'i sqarojnë këto koncepte me fjali të shkurtra dhe kuptimplota.

Shembull:

Konceptet	Sqarimet
Eksperimenti i Mendelit	
Ligji i Parë i Mendelit	
Ligji i Dytë i Mendelit	
Trashëgimia ndërmjetme	Nëse kryqëzohet bima e trëndafilit me lule të kuqe me atë me lule të bardha (siç shihet në figurë), ne marrin fara që japin bimë me lule rozë. Kjo është për shkak se gjenet për ngjyrën e luleve të kuqe (RR) dhe të bardhë (bb) janë njëjtë dominante, asnjëra nuk e dominon tjetrën. Ngjyra rozë e luleve është kështu (Rb) si rezultat i shprehjes së barabartë të ngjyrës së kuqe dhe të bardhë.





RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit ta kenë plotësuar ditarin dypjesësh, fton ata për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve. Gjatë sqarimit të koncepteve, nxënësit bazohen edhe në figurat e librit, por edhe në fotografitë që mësimdhënësi/ja paraqet në ekran. Fillimisht, fton nxënësit që janë më të tërhequr që t'i japin mendimet e tyre, pastaj vazhdon me diskutimin, nëse ndonjë sqarim nuk është interpretuar saktë nga nxënësit, atëherë sqarimet përkatëse i jep mësimdhënësi/ja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Tema (nga plani

dymujor):

Trashëgimia te njeriu

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Zbaton parimet e trashëgimisë së Menedelit për të bërë parashikime lidhur me paraqitjen e seksit/gjinisë së pasardhësit te njeriu.
- Shpjegon trashëgiminë e veçorive dominante dhe recesive te njeriu. Vlerëson rolin e trashëgimisë te njeriu.
- Hulumton me cilin kombinim të kromosomeve seksuale përcaktohet seksi mashkullor dhe ai femëror te njeriu.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II- 1. Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për të sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.

IV. 1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Vetitë e individët pasardhës caktohen nga dy gjene alele**

Fjalët kyçe: *alel, homozigot, heterozigot, gjini, X, Y*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Shpjegon trashëgiminë e veçorive dominante dhe recesive te njeriu.
Zbaton parimet e trashëgimisë së Menedelit për të bërë parashikime lidhur me paraqitjen e gjinisë;
Vlerëson rolin e trashëgimisë te njeriu.*

Kriteret e suksesit:

*Jep shembuj të parashikimeve lidhur me paraqitjen e gjinisë;
Numëro shembuj të veçorive dominante dhe recesive;
Analizo rëndësinë e trashëgimisë.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, TIK, Kimi, Matematikë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Gjatë kësaj faze mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve t'i shprehin mendimet e tyre për vetitë e trashëguara nga paraardhësit e tyre.

GRUPET E EKSPERTËVE

Mësimdhënësi/ja zgjedh të punojë përmes grupeve të ekspertëve. Nxënësit ndahen në grupe pune dhe cakton numrat nga 1-5 për secilin nxënës të çdo grupi, orientohet në libër të lexojnë secili nxënës nga një pjesë.

1-shat lexojnë: Si trashëgohen gjenet me predispozita për veti të caktuara?

2-shat lexojnë: Gjenet me predispozita dominante dhe recesive;

3-shat lexojnë: Dy prindër me sy kafe mund të kenë fëmijë me sy të gjelbër dhe të kaltër;

4-shat lexojnë: Dy prindër me sy të kaltër nuk mund të kenë fëmijë me sy kafe;

5-shat lexojnë: Përcaktimi i seksit - vajzë apo djalë?

Pasi nxënësit ta kenë kuptuar pjesën e tyre, fton që në një grup të bashkohen numrat 1 nga të gjitha grupet, pastaj në grupin tjetër numrat 2, në grupin tjetër numrat 3, në grupin tjetër numrat 4, në grupin e fundit numrat 5. Kështu, të bashkuar fton nxënësit të diskutojnë në mes tyre lidhur me atë çfarë lexuan, sa kanë mbajtur në mend, dhe këto informacione t'i shkëmbejnë me njëri - tjetrin. Pas pak minutash, fton nxënësit të kthehen në grupet e tyre fillestare dhe aty të diskutojnë prapë për atë çfarë mbajtën në mend secili për pjesën e tyre.

DISKUTIMI

Pasi të mbarojë diskutimi, për disa minuta fton nxënësit ta fillojnë diskutimin së bashku, duke i ndihmuar me pak pyetje për orientim.

Fillimisht udhëzon nxënësit të tregojnë se gjenet, që përcaktojnë një veti të vendosur në një çift kromozomesh, quhen gjene alele. Njerëzit, të cilët kanë gjene alele për të dy ngjyrat, ngjyrë kafe dhe të kaltër të syve, kanë gjasa që 75% të fëmijëve të tyre të kenë sy kafe dhe 25% të kenë sy të kaltër. Kjo sepse ngjyra kafe mbizotëron (dominon) mbi të kaltërtën. Një gjen alel dominant gjithmonë do ta shprehë karakteristikën e tij. Gjinia e një personi përcaktohet nga kombinimi i kromozomeve seksuale X dhe Y, kur qeliza vezë dhe spermatozoidi bashkohen. Femra përmban një palë kromozome të quajtura XX. Mashkulli përmban një palë kromozome të quajtura XY.

(një shembull i diskutimit)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani

dymujor):

Trashëgimia te njeriu

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Numëron disa cilësi që i përcaktojnë kromozomet autosome dhe kromozomet seksuale.
- Definon termin mutacion dhe emërton disa faktorë mutagjenë.
- Vlerëson rolin e trashëgimisë te njeriu.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I- 1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

II- 2 Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.

II-7. Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Vetitë që i përcaktojnë kromozomet autosome dhe kromozomet seksuale.**

Fjalët kyçe: *mutacion, mutagjen, sindroma Down, faktor i jashtëm.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Dallon cilësitë që i përcaktojnë kromozomet autosome dhe kromozomet seksuale;
Definon termin mutacion dhe emërton disa faktorë mutagjenë;*

Kriteret e suksesit:

*Numëro disa cilësi që i përcaktojnë kromozomet autosome dhe kromozomet seksuale;
Veço disa shembuj të faktorëve mutagjenë;
Trego shkaktarët e paraqitjes së mutacioneve.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, llaptopi, projektori (TV), fotografi.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, TIK, Kimi, Matematikë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Gjatë kësaj faze mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të shikojnë në ekran disa fotografi. U kërkon nxënësve që t'i përcjellin me vëmendje, dhe pasi t'i kenë përcjellë të gjitha fotot, fillon diskutimin se çfarë paraqesin fotografitë.



LEKSION I AVANCUAR

Mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve në pika të shkurtra se vetitë te njerëzit përcaktohen nga gjenet në kromozomet autosomike (trupore) dhe nga gjenet në kromozomet seksuale. Mutacionet janë ndryshime që shfaqen në strukturën e gjeneve ose në kromozome. Sindroma Dawn është rezultat i ndryshimit të numrit të kromozomeve, nuk është trashëguese. Mutacionet ndodhin herë pas here nga vetvetja, d.m.th. për shkak të ndërrimeve në molekulat e ADN-së. Por mutacionet janë gjithashtu shkak i sëmundjeve trashëguese, për të cilat do të mësoni më vonë. Mutacionet mund të shkaktohen edhe nga faktorë të jashtëm, p.sh. rrezatimi radioaktiv dhe kimikate të caktuara.

Pastaj u kërkon që ta lexojnë njësinë mësimore dhe pastaj të vazhdojnë me teknikën e pyetjeve.

TEKNIKA E PYETJEVE

Mësimdhënësi/ja paraqet pyetjet si më poshtë (shembull) dhe diskuton me nxënës rreth përgjigjeve të tyre.

1. Nga cilat kromozome përcaktohen vetitë te njerëzit?
2. Përshkruaj se çfarë do të thotë termi "mutacion".
3. Cilët janë shkaktarët e paraqitjes së mutacioneve?
4. Cili çrregullim në kromozome seksuale shkakton sindromën Dawn?
5. Shpjego dallimet në përçindje të daltonizmit ndërmjet meshkujve dhe femrave.
6. A është shërues trajtimi i bazuar në transfuzionet e gjakut për aneminë mesdhetare?
7. Mendo në mënyrë kritike: pse anemia mesdhetare quhet edhe talasemi?
8. A janë gjithmonë të dëmshme mutacionet?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani dymujor): Zhvillimi individual i njeriut	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Përshkruan krijimin e qelizave seksuale te njeriu (spermatogjeneza dhe oogjeneza).
--	---

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II- 2 Përzgjedh informata nga burime të ndryshme për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar, dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.

II- 7. Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.

III- 7 Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Formimi i qelizave seksuale - spermatogjeneza dhe oogjeneza**

Fjalët kyçe: *spermatogjenезë, ovogjenезë, spermatocite primare dhe oocite primare.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Përshkruan procesin e spermatogjenезës;

Shpjegon procesin e oogjenезës;

Kriteret e suksesit:

Specifiko fazat e procesit të spermatogjenезës;

Dallo spermatogjenезën nga ovogjenезa.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, llaptopi, projektori (TV), fotografi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, TIK, Kimi, Matematikë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Gjatë kësaj faze mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve t'i shprehin mendimet e tyre për procesin e spermatogjenezës dhe ovogjenezës, duke u munduar t'i kujtojnë njohuritë e tyre nga klasa e 8-të.

MËSIM I PËRQENDRUAR NË ARGUMENTE

Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që t'i hapin librat dhe ta lexojnë të ndarë në pjesë njësinë mësimore. Pasi t'i kenë lexuar praragrafët e dhënë, tani nxënësit me vëmendje përcjellin pyetjet e mësimdhënësit/es dhe gjithashtu përcjellin ilustrimet me video, duke i komentuar ato:

<https://www.youtube.com/watch?v=63hFfJOJq9>

<https://www.youtube.com/watch?v=6fBa8UqEano>

- 1. Përshkruaj procesin e spermatogjenezës dhe oogjenezës.*
- 2. Trego ngjashmëritë dhe dallimet në mes të spermatogjenezës dhe oogjenezës (paraqit përmes tabelës).*
- 3. Krahaso tipat e vezëve të llojet e ndryshme të shtazëve.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani

dymujor):

Zhvillimi individual i njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Shpjegon si kryhet frytnimi dhe formimi i zigotës.
- Përshkruan si zhvillohet shtatzënia (graviditeti).
- Përshkruan zhvillimin embrional te njeriu (nga zigota deri te lindja).
- Përshkruan zhvillimin pasembrional te njeriu (të ndarë në faza).
- Numëron dhe përshkruan etapat e zhvillimit embrional dhe pasembrional te njeriu (përmes paraqitjes figurative të ciklit jetësor të njeriut).

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I- 6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë, dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

II- 2 Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar, dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.

IV. 1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur në formë të ndryshme të të shprehurit shembuj konkretë nga jeta e përditshme.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Shtatzënia dhe lindja e fëmijës**

Fjalët kyçe: *Zigotë, frytnim, pllenimi, morula, blastula, gastrula, embrioni*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan etapat e zhvillimit embrional dhe pasembrional te njeriu;
Tregon se si kryhet frytnimi dhe formimi i zigotës;*

Kriteret e suksesit:

*Specifiko nga fotot fazat e zhvillimit embrional te njeriu;
Përshkruaj procesin e formimit të zigotës;
Sqaro si ndodh frytnimi.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, llaptopi, projektori (TV), fotografi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, TIK, Kimi, Matematikë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Gjatë kësaj faze mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve ta shikojnë në ekran një video, në të cilën bëhet fjalë për frytnimin: https://www.youtube.com/watch?v=_5OvgQW6FG4.

U kërkon nxënësve që ta përcjellin me vëmendje videon, dhe pasi ta kenë përcjellë, fillon diskutimin se çfarë kanë parë në video, çfarë është e veçanta e videos etj.

DITARI DYPJESËSH

Mësimdhënësi/ja organizon në dyshe grupet e punës. Udhëzon nxënësit se çfarë duhet të lexojnë, duke mbajtur shënime, dhe të interpretojnë, duke plotësuar modelin e ditarit dypjesësh, si në tabelë. Në njërën anë do t'i shkruajnë konceptet kryesore, e përkrah saj do t'i sqarojnë këto koncepte me fjali të shkurtra dhe kuptimplota.


Shembull:

Konceptet	Sqarimet
Pllenimi	
Morula	
Blastula	
Gastrula	
Embrioni	
Fetusi	
Foshnja	
I posalinduri	

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit ta kenë plotësuar ditarin dypjesësh, fton ata për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve.

Gjithashtu, bazuar në fotografi, nxënësit japin sqarimet e nevojshme (p.sh. fazat e zhvillimit të embrionit).



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani

dymujor):

Evolucioni

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Shpjegon teoritë e zhvillimit (evolucionit) të botës së gjallë.
- Analizon faktorët e ndryshëm evolutivë, që ndikuan në zhvillimin dhe përsosjen e qenieve të gjalla.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I- 2. Përshkruan një ngjarje, të dhënë si detyrë, të lexuar ose të dëgjuar më parë, në formë verbale, vizuale ose me shkrim, duke ruajtur rrjedhën logjike të saj.

I- 6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikon adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë, dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

II- 1. Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për ta sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Evolucioni - ndryshues i formave jetësore**

Fjalët kyçe: *fosilet, kohë gjeologjike, teoria e evolucionit*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Shpjegon teoritë e zhvillimit (evolucionit) të botës së gjallë;

Analizon faktorët e ndryshëm evolutivë, që ndikuan në zhvillimin dhe përsosjen e qenieve të gjalla;

Kriteret e suksesit:

Defino termin evolucion;

Veço karakteristikat e kohës gjeologjike.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Histori, Gjeografi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi/ja e fillon njësinë mësimore, duke shkruar në tabelë titullin e njësisë mësimore “Evolucioni - ndryshues i formave jetësore”, kërkon nga nxënësit që t’i japin mendimet e tyre, se çfarë dinë për evolucionin. Mendimet e tyre i shkruajnë në tabelë, dhe pastaj ato i krahason, pasi të jetë zhvilluar koncepti kryesor.

LEKSION I AVANCUAR

Mësimdhënësi/ja e realizon pjesën kryesore të orës mësimore përmes leksionit të avancuar, u shpjegon nxënësve në pika të shkurtra se organizmat më të thjeshtë të gjallë kanë ekzistuar që nga kohërat e lashta. Ndryshimet e vazhdueshme në mjedis mundësojnë zhvillimin e formave të reja. Evolucioni është ndryshimi i ngadaltë i organizmave me kalimin e kohës. Fosilet janë mbetjet e ruajtura të bimëve ose të kafshëve, të cilat ekzistonin miliona vjet më parë. Prania e fosileve (ngulitjet e fosilizuara të bimëve dhe kafshëve) zbulojnë se format e jetës në tokë kanë ndryshuar. Shkëmbinjtë e vjetër janë zakonisht më thellë në tokë, dhe kështu përmbajnë fosilet më të vjetra. Jeta në tokë ka ndryshuar që kur është formuar. Pastaj u kërkon nxënësve që ta lexojnë njësinë mësimore në heshtje.

KLLASTER

Pasi nxënësit ta kenë lexuar njësinë mësimore në heshtje, mësimdhënësi/ja i fton ata ta punojnë një kllaster në formë të përmbledhjes, fillimisht punojnë në grupe. Pastaj mësimdhënësi/ja i fton ata që të njëjtin ta punojnë edhe në tabelë, duke bashkëpunuar me njëri - tjetrin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani dymujor):
Evolucioni

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Shpjegon teoritë e zhvillimit (evolucionit) të botës së gjallë.
- Analizon faktorët e ndryshëm evolutivë, që ndikuan në zhvillimin dhe përsosjen e qenieve të gjalla.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-8. Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën, duke u përgjigjur dhe duke veçuar informatën kryesore.

II- 7. Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.

IV. 1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit shembuj konkretë nga jeta e përditshme.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriu, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Llojet ndryshojnë**

Fjalët kyçe: *Lamarku, Darvini, evolucion, teori evolucionare*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Sqaron teoritë e evolucionit;

Përshkruan udhëtimin e Darvinit;

Analizon se si evoluojnë llojet e reja sipas teorisë së evolucionit të Darvinit;

Kriteret e suksesit:

Shpjego kush e ka dhënë teorinë e vërtetë të evolucionit;

Veço përfundimet që arriti Darvini, pasi analizoi bimët dhe shtazët në ishullin Gallapagos;

Vlerëso teoritë e Darvinit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Histori, Gjeografi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

DISKUTIM I ORIENTUAR

Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që të diskutojnë për njohuritë e orës së kaluar, duke kaluar kështu gradualisht te njësia e radhës.

MINIGRUPET E EKSPERTËVE

Mësimdhënësi/ja zgjedh të punojë përmes grupeve të ekspertëve (grup i vogël), nxënësit ndahen në grupe pune dhe cakton numrat nga 1-3 për secilin nxënës të çdo grupi, orientohet secili nxënës të lexojë në libër nga një pjesë.

1 - shat lexojnë për teorinë e zhvillimit (evolucionit) të botës së gjallë;

2 - shat lexojnë për pjesën “Darvini dhe evolucioni”;

3 - shat lexojnë për “Darvini dhe ishujt Galapagos”.

Pasi nxënësit ta kenë kuptuar pjesën e tyre, fton që në një grup të bashkohen numrat 1 nga të gjitha grupet, pastaj në grupin tjetër numrat 2, në grupin tjetër numrat 3. Kështu, të bashkuar fton nxënësit të diskutojnë në mes tyre lidhur me atë se çfarë lexuan, sa kanë mbajtur në mend, dhe këto informacione t’i shkëmbejnë me njëri- tjetrin. Pas pak minutash, fton nxënësit të kthehen në grupet e tyre fillestare dhe aty të diskutojnë prapë për atë çfarë mbajtën në mend secili për pjesën e tyre.

DISKUTIMI

Pasi të mbarojë diskutimi për grupin, fillon diskutimi i përgjithshëm, mësimdhënësi/ja i fton nxënësit që më parë kishin lexuar për teorinë e zhvillimit (evolucionit) të botës së gjallë ta fillojnë diskutimin, pastaj po i njëjti nxënës në fund bën një pyetje për atë se çfarë ka mësuar ai dhe përgjigjet i japin nxënësit që më parë nuk e patën për detyrë të lexojnë për teorinë e zhvillimit (evolucionit) të botës së gjallë, kështu dimë se sa kemi arritur t’i transmetojmë njohuritë te nxënësit përmes nxënësve. Në këtë mënyrë vazhdohet edhe me pjesët e tjera si me bërthamën, ashtu edhe me kromozomet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

“Hulumtoni për dëshmi të tjera për evolucionin”.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Klasa: IX

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: IV

Tema (nga plani
dymujor):
Evolucioni

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Shpjegon teoritë e zhvillimit (evolucionit) të botës së gjallë.
- Analizon faktorët e ndryshëm evolutivë, që ndikuan në zhvillimin dhe përsosjen e qenieve të gjalla. Zbaton dhe komenton fjalorin dhe përkufizimet kryesore që kanë të bëjnë me evolucionin.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

II- 8. Identifikon, me anë të krahasimit, dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak - pasojë midis këtyre dukurive.

III. 7. Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Dëshmitë e tjera mbi evolucionin dhe seleksionimi natyror**

Fjalët kyçe: *seleksionim, mjedis, homologe, analoge, evolucion*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Analizon dëshmi të tjera për ta vërtetuar teorinë e evolucionit;
Vlerëson praninë e organeve homologe dhe analoge për ta vërtetuar farefisninë;
Shpjegon termin luftë për mbijetesë.*

Kriteret e suksesit:

*Shpjego procesin e zhvillimit evolutiv përmes vargut paleontologjik të kalit;
Veço se çfarë vërtetojnë organet analoge;
Analizo rëndësinë e seleksionimit natyror.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Histori, Gjeografi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

DISKUTIM PARAPRAK

Mësimdhënësi/ja i orienton nxënësit të mbledhin informacione, bazuar në njohuritë që ata kanë nga burime të ndryshme të informacionit për teorinë evolutive dhe seleksionimin natyror, po ashtu edhe për ndryshimet e llojeve.

Mësimdhënësi/ja drejton pyetjet:

Cilat argumente tregojnë që teoria e evolucionit është e vërtetë?

Çfarë dini për seleksionimin natyror?

U lë pak kohë të mendojnë, e pastaj ta fillojnë diskutimin rreth përgjigjeve.

VLD (VEPRIMTARI ME LEXIM TË DREJTUAR)

Në vijim mësimdhënësi/ja ua shpjegon nxënësve procedurën, i udhëzon nxënësit që t'i hapin librat bazë dhe ta lexojnë temën: "Dëshmitë e tjera mbi evolucionin dhe seleksionimi natyror", pasi ta lexojnë temën mësimore, me vëmendje të nxjerrin përfundime mbi të, duke u shërbyer me pyetjet, si:

- 1. Shpjego procesin e zhvillimit evolutiv përmes vargut paleontologjik të kalit;*
 - 2. Përshkruaj karakteristikat e parashpendorit;*
 - 3. Çfarë rëndësie kanë organet homologe për ta vërtetuar farefisninë?*
 - 4. Çka vërtetojnë organet analoge?*
- 1. Shpjego si pasqyron zhvillimi i fetusit të një lloji rrjedhën e zhvillimit në miliona vjet;*
 - 2. Emërto dhe përshkruaj faktorët që ndikojnë në seleksionimin natyror dhe në zhvillimin e llojeve të reja;*

3. Shpjegoni termin 'luftë për mbijetesë';
4. Çfarë kuptojmë me seleksionim natyror?
5. Shpjego rëndësinë e seleksionimit natyror;
6. Shpjegoni kuptimin "mbijetesë e llojeve më të përshtatshme";
7. Çfarë ndodh, nëse, për periudha të gjata kohore, brenda një lloji zhvillohen ndryshime, merr shembull ishullin Gallapagos.

KLLASTER

Pasi nxënësit kanë lexuar dhe kanë komentuar njësinë mësimore, mësimdhënësi/ja i fton ata ta punojnë një kllaster në formë të përmbledhjes, me njohuritë që tashmë i kanë fituar.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shkruani një ese deri në 500 fjalë për origjinën e jetës në tokë.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
 Klasa: IX

Tema (nga plani

dymujor):

Evolucioni

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Shpjegon teoritë e zhvillimit (evolucionit) të botës së gjallë.
- Shpjegon origjinën e njeriut si produkt të përzgjedhjes natyrore dhe të kushteve jetësore.
- Përshkruan origjinën e njeriut dhe numëron paraardhësit e tij.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II- 8. Identifikon, me anë të krahasimit, dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak - pasojë midis këtyre dukurive.

III. 5. Paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti, duke e sqaruar dhe duke e argumentuar më pas këtë para të tjerëve.

III. 7. Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Cila është origjina e jetës? Si ka shkuar zhvillimi i kurrizorëve?**

Fjalët kyçe: *fosile, kohë paleontologjike, evoluim, vdekje masive*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan evolucionin e organizmave të parë të gjallë dhe ata të ditës së sotme;
Sqaron kohët e zhvillimit të botës së gjallë, duke treguar shtazët karakteristike të çdo kohe;*

Analizon evoluimin e kurrizorëve nga peshqit deri te gjitarët.

Kriteret e suksesit:

Krahaso organizmat e parë të gjallë me organizmat e sotëm;

Emërto kohët e zhvillimit të botës së gjallë, të shprehura në milionë vjet nga sot;

Veço nga cilat gjallesa kanë evoluar peshqit, shpendët dhe gjitarët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Histori, Gjeografi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Gjatë kësaj faze mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve t'i shpalosin mendimet e tyre lidhur me pyetjen "Cila është origjina e jetës në tokë?". Sigurisht, nxënësit do të kenë mendime të ndryshme, sepse edhe kishin detyrë paraprake të shkruajnë një ese për origjinën e jetës në tokë.

DITARI DYPJESËSH

Mësimdhënësi/ja organizon në dyshe grupet e punës. Udhëzon nxënësit se çfarë duhet të lexojnë, duke mbajtur shënime dhe çfarë duhet të interpretojnë, duke plotësuar modelin e ditarit dypjesësh, si në tabelë. Në njërën anë do t'i shkruajnë konceptet kryesore, e përkrah saj do t'i sqarojnë këto koncepte me fjali të shkurta dhe kuptimplota.

Shembull:

Konceptet	Sqarimet
Kur u shfaq jeta për herë të parë?	
Zhvillimi i bimëve dhe i shtazëve	
Parakoha e vjetër	
Koha e vjetër	
Koha e mesme	
Koha e re	Përfshin edhe ditët e sotme. Kjo kohë karakterizohet me një zhvillim të vrullshëm të insekteve, zogjve, gjitarëve, por dhe farëveshurave. Në fund të kësaj periudhe është krijuar dhe njeriu.
Nga ujëtokësorët te zvarranikët	
Gjitarët e parë	Gjitarët e parë të njohur ishin të vegjël si minjtë dhe ushqeheshin me insekte, krimba dhe vezë. Ashtu si gjitarët modernë, ata ishin njëlloj të ngrohtë dhe të mbuluar me lesh. Kështu, ata mund të ishin aktivë gjatë netëve të ftohta, pasi shumica e zvarranikëve mund të mos ishin aktivë.

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit ta kenë plotësuar ditarin dypjesësh, fton ata për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve. Gjatë sqarimit të koncepteve, nxënësit bazohen edhe në figurat e librit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: IX

Tema (nga plani dymujor):

Evolucioni

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Shpjegon origjinën e njeriut si produkt të përzgjedhjes natyrore dhe të kushteve jetësore.
- Përshkruan origjinën e njeriut dhe numëron paraardhësit e tij.
- Analizon racat njerëzore dhe kushtet që kanë ndikuar në lindjen e racave njerëzore.
- Emëron racat kryesore dhe interpreton pikëpamjet pseudoshkencore për racat.
- Shpjegon rregullimin e jetës shoqërore të njeriut (normat shoqërore, morale dhe ligjet juridike).

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

I- 5. Prezenton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshtuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.

II-6 Demonstron zgjidhjen e një problemi (matematik, lingistik etj.) bazuar në të dhënat tekstuale ose tekstuale numerike, eksperimentale të detyrës, e cila bëhet në klasë/shkollë apo jashtë saj, duke arsyetuar me gojë zbatimin e ecurive përkatëse për arritjen e rezultatit.

III- 2. Shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burimet e tjera gjatë ndërtimit të një ideje ose projekti me bazë klase/shkollë ose jashtë saj.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Evolucioni i njeriut**

Fjalët kyçe: *Australopitekusi, Homo habilis, Homo erektu, Homo sapiens, Njeriu neandertal*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Përshkruan origjinën e njeriut;

Analizon racat njerëzore dhe kushtet që kanë ndikuar në lindjen e racave njerëzore;

Emëron racat kryesore dhe interpreton pikëpamjet pseudoshkencore për racat; Shpjegon rregullimin e jetës shoqërore të njeriut (normat shoqërore, morale dhe ligjet juridike).

Kriteret e suksesit:

Numëro paraardhësit e njeriut;

Veço kushtet nëpër të cilat kanë jetuar racat njerëzore;

Vlerëso rregullat e jetës shoqërore të njeriut.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Histori, Gjeografi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Gjatë kësaj faze mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve t'i shpalosin mendimet e tyre lidhur me pyetjen "Cili është evolucioni i njeriut?". Sigurisht, nxënësit do të kenë mendime të ndryshme, dhe ato i shkruajnë në tabelë, për t'i krahasuar me mendimet e tyre në fund, që do të krijohen pasi ta kenë analizuar tekstin.

DITARI DYPJESËSH

Mësimdhënësi/ja organizon në dyshe grupet e punës. Udhëzon nxënësit se çfarë duhet të lexojnë, duke mbajtur shënime dhe çfarë duhet të interpretojnë, duke plotësuar modelin e ditarit dypjesësh, si në tabelë. Në njërën anë do t'i shkruajnë konceptet kryesore, e përkrah saj do t'i sqarojnë këto koncepte me fjali të shkurtra dhe kuptim-plota.

Shembull:

<i>Konceptet</i>	<i>Sqarimet</i>
Australopitekusi	
Homo habilis	
Homo erectus	
Homo sapiens	
Njeriu neandertal - njeriu parabashkëkohor që nuk mbijetoi	
Njeriu bashkëkohor - modern	
Racat njerëzore	Në bazë të karakteristikave, shkencëtarët të njerëzimit dallojnë këto raca kryesore: nigride, australoide, kaukazoide, mongolide dhe kapoide.

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit ta kenë plotësuar ditarin dypjesësh, fton ata për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve. Gjatë sqarimit të koncepteve, nxënësit bazohen edhe në figurat e librit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyese, vlerësim i ndërsjellë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Klasa: IX

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: IV

Tema (nga plani dymujor):
Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Shpjegon konceptet dhe përkufizimet themelore të trupit të njeriut.
- Analizon faktorët të cilët ndikojnë në shëndetin fizik dhe emocional të njeriut.
- Vlerëson rolin e shëndetit për njeriun.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II- - 1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

III- 7 *Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.*

VI 1. Praktikon të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë në situata konkrete jetësore të përditshme, qoftë në klasë, qoftë në shkollë apo gjetiu (si: gjatë diskutimit, respektimit të mendimit të tjetrit etj).

VI-6. Identifikon paragjykimet apo dukuritë jo të mira në klasë, në shkollë apo në komunitet, merr qëndrim ndaj tyre, duke propozuar veprime konkrete për luftimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, te shtazët, te bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Trupi i njeriut dhe shëndeti**

Fjalët kyçe: *shëndeti, faktor mjedisor, faktor gjenetik, shëndet mendor*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Shpjegon konceptet dhe përkufizimet themelore të trupit të njeriut;
Emërton faktorët që ndikojnë në shëndetin fizik dhe mendor.
Vlerëson rolin e shëndetit për njeriun;*

Kriteret e suksesit:

*Përshkruaj strukturën trupore të njeriut;
Sqaro kur kemi një shëndet fizik dhe një shëndet mendor të mirë.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Histori, Edukatë qytetare.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Këtë orë mësimore mësimdhënësi/ja e fillon, duke pyetur nxënësit se çfarë kuptojnë me shëndet dhe, sigurisht, përgjigjet e tyre do të jenë të ndryshme ose do të jenë rreth kësaj përgjigjeje:


Shëndeti është një gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe shoqërore, dhe jo thjesht mungesa e ndonjë sëmundjeje. Shëndeti i mirë ndikon në parandalimin e stresit dhe mundëson një jetë më të gjatë, më aktive. Ne duhet të kuptojmë ç'është shëndeti i mirë, aktivitetet që një individ duhet t'i bëjë, në mënyrë që ta ruajë shëndetin e mirë.

Mendimet e nxënësve shkruhen në tabelë në formë konceptesh, në mënyrë që të bëhet një përmbledhje në fund të orës mësimore.

MBAJTJE E STRUKTURUAR E SHËNIMEVE

Mësimdhënësi/ja paraqet në tabelë një organizues grafik që thekson veçoritë e shëndeti mendor dhe fizik. Nxënësit do të mbajnë shënime për informacionin e duhur në hapësirat, në skicën e grafikut, duke përshkruar dhe duke analizuar faktorët e ndryshëm që ndikojnë në shëndetin e njeriut. Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që ta respektojnë plotësimin e kutive në rrugë logjike, pasi të kenë lexuar në dyshe një fragment të caktuar. Është me rëndësi që çdo kuti të ketë të dhëna të caktuara, fakte që ata i gjejnë në tekst dhe i plotësojnë hap pas hapi.

Shëndeti mendor



Trupi i njeriut

Shëndeti fizik

Shëndeti fizik ruhet, duke u kujdesur për zvogëlimin e rrezikut nga një dëmtim ose pakujdesi shëndetësore, të tilla si: zvogëlimi i rreziqeve në vendin e punës, përdorimi i mjeteve kontraceptive gjatë marrëdhënieve seksuale, të praktikuarit e higjienës trupore, largimi nga përdorimi i duhanit, i alkoolit ose i drogave ilegale, marrja e vaksinave të rekomanduara për një gjendje apo vend specifik kur udhëtojmë, marrja e trajtimit mjekësor për ta ruajtur ekuilibrin e shëndetit, kur është e nevojshme.

RRJETI I DISKUTIMIT
Pasi nxënësit ta kenë plotësuar organizuesin grafik, fton ata për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: IX

Tema (nga plani

dymujor):

Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Respekton diversitetin në seksualitet dhe orientimin seksual.
- Argumenton përparësitë dhe rreziqet gjatë marrjes së vendimit rreth marrëdhënieve seksuale.
- Diskuton për shtatzëninë, duke analizuar prindësinë në moshë të re (adoleshencë).
- Analizon të drejtat riprodhuese dhe identifikon stigmën, diskriminimin, abuzimin etj., në situata të ndryshme.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

III-7 Shfrytëzon teknika të ndryshme në mënyrë të efektshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

V.7. U shpjegon moshatarëve, me forma dhe mjete të ndryshme të komunikimit, rëndësinë e identifikimit të personave dhe shërbimeve kompetente, veç e veç, të nevojshme për mbështetje në situata që konsiderohen potencialisht të rrezikshme për shëndetin fizik dhe mendor.

V-9. Reagon ndaj sjelljeve asociiale të moshatarëve, duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehjet negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo i drogës).

VI 6. Identifikon paragjykimet apo dukuritë jo të mira në klasë, në shkollë apo në komunitet, merr qëndrim ndaj tyre, duke propozuar veprime konkrete për luftimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarëve të sëmundjeve të njeriut, shtazëve, bimëve dhe mënyrave të kontrollit të tyre, metabolizmit, zhvillimit individual të njeriut dhe evolucionit të qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Diversiteti në seksualitet te njerëzit**

Fjalët kyçe: *heteroseksual, homoseksual, biseksual, abuzim, partner*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Shpjegon diversitetin në seksualitet dhe orientimin seksual;

Sqaron pse pasojat e abuzimit janë veçanërisht të rënda në moshën adoleshente.

Kriteret e suksesit:

Dallo orientimet seksuale;

Trego shkaqet e abuzimit seksual në moshën e adoleshencës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, tabela, shkurtesa.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Edukatë qytetare.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

DI/DUA TË DI/MËSOVA

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë tabelën “Di/Dua të di/ Mësova” dhe kërkon që edhe nxënësit ta punojnë të njëjtën në fletoret e tyre. Në kolonën Di ata do të shkruajnë çfarë dinë për diversitetin seksual, abuzimin seksual, sigurisht nuk do të kenë shumë vështirësi në plotësimin e kolonës së parë, pasi këta terma tashmë janë të njohur për ta. Pasi ta plotësojnë këtë kolonë për disa minuta, u kërkon disa nxënësve që mendimet e tyre t’i shkruajnë në tabelë.

Pataj, kërkon nga nxënësit që ta lexojnë tekstin nga libri. Pas leximit, i udhëzon ata që të shkruajnë pyetje në kolonën Dua të di, pra çfarë ata duan të dinë më shumë lidhur me tekstin që lexuan. Ndërsa për pyetjet që nxënësit kanë shkruar fillimisht, pyeten nëse dinë të përgjigjen, pastaj nëse nuk ka përgjigje, atëherë mësimdhënësi u jep përgjigje. Kështu nxënësit plotësojnë kolonën Mësova.

Di	Dua të di	Mësova

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Klasa: IX

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: IV

Tema (nga plani

dymujor):

Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

- Shpjegon shkaqet e paraqitjes së sëmundjeve seksuale dhe vlerëson rolin e higjienës personale për evitimin e tyre. Emërton disa sëmundje që lidhen me seksin dhe përshkruan si shfaqen ato.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

V.7. U shpjegon moshatarëve, me forma dhe mjete të ndryshme të komunikimit, rëndësinë e identifikimit të personave dhe të shërbimeve kompetente, veç e veç, të nevojshme për mbështetje në situata që konsiderohen potencialisht të rrezikshme për shëndetin fizik dhe mendor.

V-8. Përshkruan mundësitë, rreziqet dhe pasojat e infeksioneve dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe sqaron mënyrat dhe mjetet për parandalimin e tyre, duke përdorur forma të ndryshme të prezentimit (të folur, të shkruar, grafike, pllakate, pamflete, lojë teatrale, performancë artistike etj.).

V-9. Reagon ndaj sjelljeve asociale të moshatarëve, duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehjet negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo i drogës).

VI 6. Identifikon paragjykimet apo dukuritë jo të mira në klasë, në shkollë apo në komunitet, merr qëndrim ndaj tyre, duke propozuar veprime konkrete për luftimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe roli i higjienës personale për evitimin e tyre**

Fjalët kyçe: *kërpudha kandida, trichomonas vaginalis, gonorrea, herpesi gjenital*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Shpjegon shkaqet e paraqitjes së sëmundjeve seksuale;

Vlerëson rolin e higjienës personale;

Përshkruan disa sëmundje që lidhen me seksin;

Kriteret e suksesit:

Emërto disa sëmundje që lidhen me seksin;

Numëro shkaqet e shfaqjes së sëmundjeve seksuale;

Argumento rolin e higjienës personale.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, tabela, shkumësi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Edukatë qytetare.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Gjatë kësaj faze mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve t'i shpalosin mendimet e tyre lidhur me temën "Sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe roli i higjienës personale për evitimin e tyre". Sigurisht nxënësit do të kenë njohuri paraprake, sepse këta tema janë diskutuar edhe në shkollimin e mëhershëm.

DITARI DYPJESËSH

Mësimdhënësi/ja organizon në dyshe grupet e punës. Udhëzon nxënësit se çfarë duhet të lexojnë, duke mbajtur shënime dhe çfarë duhet të interpretojnë, duke plotësuar modelin e ditarit dypjesësh, si në tabelë. Në njërën anë do t'i shkruajnë konceptet kryesore, e përkrah saj do t'i sqarojnë këto koncepte me fjali të shkurtra dhe kuptimplota.

Shembull:

<i>Konceptet</i>	<i>Sqarimet</i>
Candida albicans	
Trichomonas vaginalis	
Klamidia	
Herpesi gjenital	
Gonorrhea	
Sifilizi	Sifilizi shkaktohet nga bakteret. Kjo sëmundje ndodh në tri faza. Kur arrin faza e tretë, sëmundja është e pashërueshme.
SIDA	
Virusi HIV	

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit ta kenë plotësuar ditarin dypjesësh, fton ata për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve. Gjatë sqarimit të koncepteve nxënësit bazohen edhe në figurat e librit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës		Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV
Klasa: IX			
Tema (nga plani dymujor): Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): <ul style="list-style-type: none"> • Emërton dhe dallon sëmundjet trashëguese të njeriut. • Vlerëson rolin e shëndetit për njeriun. 	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): <p>V. 7. U shpjegon moshatarëve, me forma dhe mjete të ndryshme të komunikimit, rëndësinë e identifikimit të personave dhe të shërbimeve kompetente, veç e veç, të nevojshme për mbështetje në situata që konsiderohen potencialisht të rrezikshme për shëndetin fizik dhe mendor.</p> <p>V-8. Përshkruan mundësitë, rreziqet dhe pasojat e infeksioneve dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe sqaron mënyrat dhe mjetet për parandalimin e tyre, duke përdorur forma të ndryshme të prezentimit (të folur, të shkruar, grafike, pllakate, pamflete, lojë teatrale, performancë artistike etj.).</p> <p>V-9. Reagon ndaj sjelljeve asociale të moshatarëve, duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehitë negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo i drogës).</p> <p>VI 6. Identifikon paragjykimet apo dukuritë jo të mira në klasë, në shkollë apo në komunitet, merr qëndrim ndaj tyre, duke propozuar veprime konkrete për luftimin e tyre.</p>			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): <i>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke iu referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla. Dallon shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, të shtazët, të bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogarit nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.</i>			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Sëmundjet trashëguese të njerëzimit			
Fjalët kyçe: <i>monogjene, poligjenike, fenilketonuria, anemia mesdhetare – Beta talasemia, sindroma Marfan</i>			

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Dallon sëmundjet trashëguese të njeriut.

Përshkruan sëmundjen e anemisë mesdhetare;

Kriteret e suksesit:

Emërto disa sëmundje trashëguese te njeriu;

Numëro shkaqet e shfaqjes së sëmundjeve trashëguese;

Vlerëso rolin e shëndetit për njeriun.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri Biologjia 9, tabela, shkumësi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Edukatë qytetare.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Gjatë kësaj faze mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve t'i shpalosin mendimet e tyre lidhur me temën "Sëmundjet trashëguese te njeriu". Sigurisht, nxënësit do të kenë mendime të ndryshme, të cilat do t'i shpalosin.

DITARI DYPJESËSH

Mësimdhënësi/ja organizon në dyshe grupet e punës. Udhëzon nxënësit se çfarë duhet të lexojnë, duke mbajtur shënime dhe çfarë duhet të interpretojnë, duke plotësuar modelin e ditarit dypjesësh, si në tabelë. Në njërën anë do t'i shkruajnë konceptet kryesore, e përkrah saj do t'i sqarojnë këto koncepte me fjali të shkurtra dhe kuptimplota.

Shembull:

Konceptet	Sqarimet
Fenilketonuria	
Anemia mesdhetare – Beta talasemia	
Diabeti	
Sindroma marfan	
Fibroza cistike	
Anemia me qeliza drapër	
Sëmundja e veshkave policistike	Një nga sëmundjet më të zakonshme trashëguese të veshkave është sëmundja e veshkave policistike, e shkaktuar nga mutacionet në një prej gjeneve të kromozomeve autosomale dominante. Karakterizohet nga prania e cistave në të dy veshkat.
Daltonizmi	
Hemofilia	
Distrofia muskulore	
Miopia	Miopia (shkurtpamësia) është një çrregullim gjenetik shumë i zakonshëm i shikimit. Trashëgimia është e lidhur me mutacionet në gjenet e vendosura në kromozomin X, një nga dy kromozomet seksuale në secilën qelizë.

(shembull)

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit ta kenë plotësuar ditarin dypjesësh, fton ata për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve. Gjatë sqarimit të koncepteve nxënësit bazohen edhe në figurat e librit.


VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellë).


DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

TESTI VLERËSUES

Emri & Mbiemri _____, Klasa IX/___ Data _____ Pikët		
1.	Shpjego se çfarë kupton me konceptin trashëgimi?	3
2.	Përshkruaj ndërtimin e bërthamës qelizore (bazuar edhe në fotografi)? 	4
3.	Defino termin mutacion dhe emërto të paktën dy faktor mutagjenë.	3
4.	Rretho përgjigjen e saktë. Sa është numri i kromozomeve <i>trupore</i> te njeriu? a) 20 palë çifte b) 21 palë çifte c) 22 palë çifte d) 23 palë çifte	1
5.	Numëro përbërësit e molekulës së ADN-së?	4
6.	Zbato parimet e trashëgimisë së Mendelit për të parashikuar paraqitjen e cilësive në pasardhës. (Kujto shembujt nga libri).	6

7.	Krahaso mitozën dhe mejozën.	4
8.	Rretho e saktë ose e pasaktë? Spermatogjeneza është proces që kryhet në gypat e Fallopit. Saktë / Pasaktë Ovogjeneza është proces që kryhet në gypat seminifer të testikujve. Saktë / Pasaktë Në fund të ovogenezës fitohet një qelizë vezë dhe 3 truptha polar. / Pasaktë Ligji i kombinimit të lire është njëri nga 2 ligjet e Mendelit . Saktë / Pasaktë	4 Saktë
9.	Lidh/ bashko a) Sindroma e Daunit a) Sindroma të lidhura për çiftin e fundit të kromozomeve b) Sindroma e Klinefelterit (gjininë) c) Sindroma e Eduardit d) Sindroma e Pataut b) Sindroma të lidhura për kromozomet trupore	4
10	Përshkruaj si zhvillohet shtatzënia. .	4
11	Emërto etapat e zhvillimit embironal dhe pasembrional te njeriu bazuar në fotografi. . _____ _____ _____ _____	6

		
12	Vlerëso rolin e kromozomeve në trashëgimi.	7

Suksese!

5
0

Kriteri i suksesit

Pikët	0-19	20-29	30-39	40-44	45-50
Nota	1	2	3	4	5